



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 04 qershor 2021, në mbledhjen e XLVIII (dyzet e tetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive (DA, DKRS, DBF, DPZHE, DPKGJ, DSHMS) të Komunës së Podujevës, përfaqësues të OJQ – DFK, përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i zyrtarëve komunal.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë. Kuorumi për punë dhe vendimmarrje ekziston andaj mund të vazhdojmë me punë, materialet gjithashtu i keni marrë me kohë përshirë edhe rendin e ditës dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, atëherë vetëm dua t'ju informojë që në takimin e KPF-së me kërkesë të këshilltares z.Adelinë Stublla dhe përkrahje të komitetit nga rendi i ditës është hequr tema e Arsimit meqë ne e kishim para disa ditësh seancën e jashtëzakonshme rreth kësaj pike të rendit të ditës, andaj për këtë arsye është rekomanduar të hiqet nga rendi i ditës, ndërsa me kërkesë të Kryetarit të Komunës, propozimi i drejtoreshës së DPKGJ i është përcjellë Kuvendit që të hyjë në rend të ditës edhe ky propozim si një pikë e veçantë, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni.

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, theksoi, fillimisht kërkoj mirëkuptim nga ana juaj për këto dy pika të rendit të ditës të cilat kanë të bëjnë me vendimin e viti 2010 dhe atë të vitit 2013, konkretisht nëse përkrahen nga Kuvendi, kërkoj të zhvendosen në pikë 1 të rendit të ditës në këtë seancë, arsyeja pse po kërkoj këtë është sepse kam një takim me përfaqësuesit e ATK-së të cilët veç kanë ardhur në Podujevë, prandaj edhe njëherë kërkoj kërkoj mirëkuptim nga ana juaj.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra kemi kërkesën e drejtoreshës së DPKGJ-së që 2 propozim vendimet që janë propozuar dhe rekomanduar nga KPF që kjo pikë të hyjë si pikë e parë e rendit të ditës, arsyeja është se drejtoresha ka një takim me përfaqësuesit e ATK-së dhe dëshiron që këtë pikë ta vendos si pikë të parë të rendit të ditës, pra të bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës. Nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e ditës me konstatimet e KPF-së dhe propozimin e drejtoreshës së DPKGJ-së që pika e cekur të hyjë si pikë e parë e rendit të ditës.

Njëzëri miratohet rendi i ditës sipas konstatimeve të KPF-së, propozimit të drejtoreshës së DPKGJ-së, si dhe propozimit për heqjen nga rendi i ditës të pikës 10 (informatë e Drejtorisë së Arsimit), përkatësisht rendi i ditës miratohet me pikat si në vijim:

1. **Propozim vendimet e kryetarit të Komunës;**
 - *Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.prot.01/148-350 datë 29 prill 2010, për caktimin e Zonës Industriale në fshatin Livadicë;*
 - *Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.prot.01/60-02 datë 28 mars 2013, për përcaktimin në interes publik të një pjese të tokave të ish Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Komunës së Podujevës*
2. **Propozim Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës.**
 - *Raporti nga mbajtja e diskutimit publik*
3. **Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës**
 - *Raporti nga mbajtja e diskutimit publik*
4. **Propozim Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës**
 - *Raporti nga mbajtja e diskutimit publik*
5. **Propozimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr.prot.01-352/04-0023112/20 të datës 22 maj 2020 e ndërlidhur me Rregulloren bazë nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës.**
6. **Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale.**
 - *Propozim vendimi për vënie në diskutim publik*
7. **Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare me destinim për subvencionimin e Klubit të Futbollit Llapi - Podujevë.**
8. **Propozim Vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë- 38**
9. **Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, rreth gjendjes së Pylltarisë në territorin e Komunës së Podujevës**
10. **Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i ngritur me Vendimin nr.prot.01-500/01-0087376/18 datë 02 nëntor 2018 (zëvendësimi i një anëtar)**
11. **Të ndryshme**

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë vazhdojmë me rendin e ditës sipas asaj që u miratua paraprakisht.

1. Propozim vendimet e kryetarit të Komunës

- *Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.prot.01/148-350 datë 29 prill 2010, për caktimin e Zonës Industriale në fshatin Livadicë;*
- *Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.prot.01/60-02 datë 28 mars 2013, për përcaktimin në interes publik të një pjese të tokave të ish Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Komunës së Podujevës*

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, përkatësisht 2 propozim vendimeve përkatëse, theksoi, ashtu siç jeni njoftuar përmes materialit të cilat i kemi përcjellë kjo çështje ka të bëjë me plotësim ndryshimin e dy ngastrave kadastrale, dhe atë, vendimi i Kuvendit komunal i datës 29 prill 2010 se do të plotësohet dhe ndryshohet në dy

ngastra kadastrale për shkak të gabimeve teknike si dhe sipërfaqja e gjithmbarshme që figuron në atë vendim, si dhe kemi të bëjmë me vendimin e vitin 2013 që po ashtu ndryshohet sipërfaqja e tërësishme, të dyja këto dy propozim vendime me të një rëndësie të veçantë dhe në interes të veçantë të Komunës së Podujevës. Arsyeja pse po kërkojë që të bëhen këto ndryshim plotësime është se janë duke u zhvilluar procedurat në Ministrinë e Pushtetit Lokal, pra në nivel qendror në mënyrë që të bëhet bartja përfundimtare e këtyre pronave në pronë komunale, në bazë të vendimit të Qeverisë.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i asamblistëve të LVV-së përkrahë që sa më shpejt të bëhet korrigjimi i gabimeve në lidhje me ngastrat kadastrale në mënyrë që të hapet rruga për caktimin e zonës industriale në fshatin Livadicë, një zonë kjo e cila strategjikisht është më e përshtatshme për funksionimin sa më efikas të një zone me interes për zhvillim ekonomik të Komunës e posaçërisht të bizneseve me qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive më të favorshme për ushtrimin e veprimtarive. Po ashtu e mbështesim dhe ndryshimin e plotësimit të vendimit që një pjesë e tokave të ndërmarrjeve shoqërore të kaloj në pronësi Komunës.

z.Hasan Ajeti, nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së theksoi, dëgjuam drejtoreshën e DPKGJ-së për këtë pikë të rendit të ditës që realisht është ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr.01/148-350 të datës 29 prill 2010, dhe arsyetimi që këtu do të bëhen disa korrigjime sa i përket gabimeve të ngastrave kadastral të sipërfaqes aktuale, ajo që ka interes nga ana ime për ta ditë është rreth pronave kur diskutohet që barten prej pronave shoqërore, në çoftë se nuk gaboj në atë kohë kryeministër ka qenë z.Ramush Haradinaj, është marr një vendim për këto prona dhe ato prona janë bartë në kompetencë të pushteteve lokale, mirëpo unë sa kam njohuri ai vendim është atakuar nga ish Presidenti i asaj kohe, në çoftë se nuk është ashtu atëherë na sqaroni këtu dhe a jeni të saktë dhe argumentueshëm që këto propozim vendime që ju i keni sjell këtu, që nesër nuk paraqesin ndonjë telashe, ne mund të marrim vendim sepse askush prej nesh nuk është kundër projekteve që kanë interes kapital për Komunën por gjithmonë duke vlerësuar që aktet që nxjerrën këtu të jenë në harmoni. Në rast se e merr dhe e lexon çartë në kohen sa ka qenë kryeministër z.Ramush Haradinaj është prodhuar ky vendim i Zyrës së Kryeministrit, e tani ne çoftë se ka ndryshuar është mirë që të silllet dëshmi dhe të publikohen para këtij Kuvendi, në çoftë se ka një akt tjetër që e ka shfuqizuar aktin e ish Kryeministrit sepse unë e thashë edhe më herët dhe po e përsëris sërish që ka qenë presidenti z.Hashim Thaqi i asaj kohe i cili i ka dërguar në Gjykatë ato vendime e që ka mundur të prodhojë telashe në bazë të arsyetimit me pronat e Komunave me shumicë Serbe në bazë të këtij, ndërsa sa i përket çështjes së sipërfaqes – m² ha, është mirë të jetë në detaje sepse gjykojë që është një ndër dokumentet më strategjike dhe më të nevojshme për komunën, përndryshe në çoftë se ne nuk i kemi këto përgjigje nga ana juaj dhe gjithmonë duke u mbështetur në bazën ligjore është normale që Grupi i LDK-së nuk do ta mbështesë këtë si pikë.

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ-së, theksoi, po ashtu sikurse ju, jemi në dijeni që Qeveria e z.Ramush Haradinaj ka nxjerr vendim dhe është aprovuar propozimi i Ministrisë së Pushtetit Lokal që një pjesë e pronave të ndërmarrjeve shoqërore të kthehen në prona komunale. Gjithashtu është e vërtetë se Presidenti i atëhershëm z.Hashim Thaqi ka bërë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të RKS-së që të pezullohet ky vendim, Kryeministri i atëhershëm z.Ramush Haradinaj ka bërë pezullim të këtij vendimi, mirëpo Gjykata Kushtetuese ka nxjerr vendim që ajo çështje nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese dhe para dorëheqjes së ish Kryeministrit z.Ramush Haradinaj është hequr pezullimi dhe i kemi 3 shkresa në formë zyrtare, vendimin e aprovimit tanimë i kam këtu, ndërsa dy të tjerat mund të shkoj dhe t'i marr në zyrë, ndërsa sa i përket ndryshimit që po kërkojmë të bëhen me këto propozim vendimeve sipas certifikatës së pronësisë e cila është zyrtare e kemi përcjell me material dhe ngastrat që kërkohet të korrigjohen është renditja e tyre, numri nuk është në zonë industriale sepse është pronë e kooperativës por është numri 222 që secili prej jush

mund ta shikoj dhe të vlerësoj se a është gabim teknik që ka rrjedhur gjatë shtypjes apo jo, do të thotë parcelë 22 nuk ka ne atë zonën industriale që është kërkuar të bëhet në fshatin Livadicë, por është parcela 222, edhe tek numri 166 është parcela 266 sipërfaqja është e njëjtë edhe në vendim, por edhe në certifikatë pronësore është sipërfaqja e njëjtë, është pronë shoqërore e kooperativës bujqësore që çfarëdo që dëshironi ne i kemi dhe mund t'ju prezantojmë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, e nderuar drejtoresh, ju e potencuat që për vendimin e ish Kryeministrit respektivisht edhe i ish Presidentit do të thotë Gjykata ka nxjerr konkluzë që nuk është kompetencë e saj që ta shqyrtoj këtë materie, tani ky vendim që ju po i referoheni a është vendim në fuqi sipas z.Ramush Haradinaj apo Kryeministrave tjerë që kanë ardhur e që aktualisht është z.Albin Kurti, a keni informacione të sakta dhe a ke dëshmi që neve na lejohet të veprojmë proceduralisht me këtë akt sepse ky akt ka qenë i kontestueshëm dhe është goditur me mjete të rregullta juridike, por në rast se ti thua që është në fuqi, prezantoje para Kuvendit dhe atëherë i heqim të gjitha dilemat.

Edhe një pyetje tjetër e kam rreth atyre pronave, a ka konteste pronësore në zonën që i'u referove në fillim e nderuar drejtoresh, në rast se nuk ka atëherë unë e gjykoj në këtë rast, a keni pas informata të sakta kur e ke përcjellë këtë rend të ditës, dhe në bazë të materialit dhe të pozicionit të funksionimit që ke ti si drejtoresh e DPKGJ, a ke informata se mund të ketë apo që ka kontest pronësor në atë zonë sepse ne e dimë që jo vetëm në Podujevë por edhe në shumicën e Kosovës ka pasur telashe rreth këtyre pronave.

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ-së, theksoi, unë vetëm po dëshiroj t'ju informoj që edhe Kryetari i mëparshëm i Komunës z.Agim Veliu ka bërë kërkesë disa herë në Ministrinë përkatëse të bëhet bartja e pronave dhe rregullimi i tyre dhe ka qenë iniciativë e tij në bazë të shkresave që këto prona të kthehen në pronë komunale, arsyet në bazë të asaj çfarë jemi informuar nga Ministrinë përkatëse ka qenë edhe pagesa e 20% të cilën nuk e kanë marr askush përsipër ta realizoj. Sa i përket vendimit tani të qeverisë së re ne lidhje me vendimin e ish kryeministrit z.Ramush Haradinaj, nuk ka ndonjë argument apo bazë se a është në fuqi ende ky vendim apo jo, mirëpo edhe me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave komunale, komunat kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për bartje të pronës së menaxhuar nga pushteti qendror, kurse sa i përket kontesteve pronësore ne kemi bërë kërkesë zyrtare ne Agjensionin Kosovar të Privatizimit dhe kemi kërkuar konfirmim dhe pëlqim prej tyre a janë këto prona të lira nga të gjitha barrat, mirëpo zyrtarisht ende nuk kemi marr ndonjë konfirmim.

z.Hasan Ajeti, theksoi, askush nuk po e konteston interesin komunal, as në kohën e qeverisjes së LDK-së e as të LVV-së. I gjithë interesimi i pyetjeve që i parashtrova ka të bëjë me sqarimin e kontestit që është prodhuar prej dy zyrtarëve më të lartë të shteti që sot realisht as ju nuk keni informata konkrete as akt konkret që e qartëson këtë normë, këtu është defekti jo pse jeni ju sepse ju nuk keni qenë në qeveri apo në presidencë por ai vendim është prodhuar në një moment dhe është pezulluar në një moment tjetër, do të thotë që në këtë rast ne presim prej teje që të na informoni, tani e nderuar drejtoresh a ke informata të sakta dhe koncize lidhur me temën për të cilën ne po diskutojmë sepse është temë mjaftë me rëndësi, në këtë kontest unë mendoj dhe parashtrova pyetje, përgjigjja jote ishte që ne kemi bërë kërkesë në institucione përkatëse, por përgjigje nuk kemi.

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ-së, theksoi, ne përgjigje prej AKP-së nuk kemi, ndërsa prej Ministrisë përkatëse po kemi, dhe ua kam përcjellë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, tani a është logjike me konstatuar dhe është legjitime të mendoj unë si asamblist, është rrezik që mundet të ketë mjegull, besoj që po e lexon drejt kuptimin e mjegullës juridike e nderuar drejtoresh dhe unë të admiroj për guximin që e ke vendosur si pikë të rendit të ditës këto çështje me këto prova me këto fakte që i keni ju në këtë çështje jashtëzakonisht të ndjeshme sepse kur flitet për prona është jashtëzakonisht çështje e ndjeshme, të jemi shumë të

sinqertë aq është e ndjeshme sa që ka shkuar në nivelin më të lartë të shtetit dhe kanë interferuar në çështje të tilla, do të thotë ti drejtoresh nuk ke sot një akt që mund t'i referohesh rreth asaj që ka për të pasur telashe në mes të dy institucioneve të Republikës, po ashtu tek kontestet pronësore për atë zonë që biseduam dhe realisht pyeta por që ju realisht përgjigje nuk keni prej organit kompetent që është Ministria përkatës si dikaster i Qeverisë, ndërsa AKP-ja është organi i vetëm legal dhe legjitim që është marr me asetet e pronave shoqërore, përderisa nuk janë këto që i ceka, unë gjykoj që e mira e së mirës ka qenë që si temë e rendit të ditës të tërhiqet krejt dhe të mos votohet sepse ka shumë mjegull në këtë proces, mund ta lësh për ndonjë prej seancave të tjera të radhës me arsyetimin se jemi duke i përgatitur faktet dhe provat materiale që i ke, dhe nuk mundemi të vazhdojmë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë i dëgjova fjalimin e drejtoreshës së DPKGJ-së dhe kolegut z.Hasan Ajeti, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së në parim e kemi mbështetur në KPF këtë çështje si pikë të rendit të ditës, pikë e cila mendoj se edhe në të kaluarën ka qenë një prej temave të debateve politike të kandidatëve për kryetar komune, por Podujeva është pa zonë industriale ende.

Në bazë të parimit juridik apo moral këtë duhet ta dijë Ekzekutivi apo pushteti aktual, duhet ta dijë dhe drejtori i kaluar i DPKGJ-së dhe drejtoresha aktuale e DPKGJ-së, ku janë pikat e pronave komunale dhe ku janë kontestet juridike, nëse pushteti nuk e din, opozita e ka paksa më të vështirë sepse nuk ka qasje të drejtpërdrejtë institucionale as në nivelin qendror e as lokal por vetëm duhet të shkojmë me kërkesa për qasje në dokumente zyrtare. Çështja tjetër është që nëse kjo pronë votohet sot ashtu siç është votuar në të kaluarën çështja e palestrës të sporteve dhe ka mbetur pa filluar puna për shkak se prona dhe objekti ka dal pjesë e pronës së AKP-së dhe është bllokuar me një vendim apo me një ankesë të AKP-së dhe tani Podujeva është pa palestër sportive. Nuk kisha dashur që kjo temë të politizohet për arsye se vetëm 5 premtime i kanë pasur kandidatët për Kryetar komune, qoftë z.Shpejtim Bulliqi, qoftë z.Agim Veliu qoftë kandidatët tjerë nga PDK dhe AAK, dhe atë Spitalin e Podujevës, Zonën industriale, Palestrën e Sportit, Ambientin dhe Punësimin, por që asnjërin nuk i kanë realizuar dhe Podujeva është në gjendje të rënduar.

Çështja tjetër, juridikisht nëse një vendim ka qenë në fuqi para ardhjes së z.Ramush Haradinaj kryeministër ishte z.Isa Mustafa dhe pezullimin e vendimit pas ankesës në Gjykatën Kushtetuese që e ka bërë Presidenti, do të thotë mbetet në funksion vendimi që ka qenë, pa u miratuar mbetet ai që është sepse nuk ka ndryshim, por i gjithë problemi është që këtu po e shohim që as drejtoresha e DPKGJ-së nuk e dinë me cilin vendim ka për të punuar. Me vendimet populliste apo me vendime të Kuvendit nuk dënohet askush edhe nëse marrim një vendim të gabuar ai kthehet këtu sërish, prandaj e them që nuk është mirë të marrim një vendim sikurse atë për Palestrën e Sportit që ka qenë propozim vendim i lajthitur i Drejtorisë. Tani për atë pronën/parcelën 222 duhet ta thërrasim ish drejtorin z.Abaz Llugaliu dhe ta pyesim se ku është ajo pronë sepse aty janë të gjitha ngastrat gabim, kurse për të gjitha gabim teknik nuk mund të jetë, mund ta bëjë një gabim teknik për një ngastër por jo të gjithë ngastrave ngase asnjë numër i ngastrave në letër aty nuk është në rregull, çështje kjo e cila është trashëguar apo si ka ndodh nuk po jam në dijeni tani se si ka ardhur çështja deri aty.

Ne duhet të sqarohemi njëherë, kemi kaluar ne pikën e parë të rendit të ditës për shkak të angazhimeve që i ka drejtoresha e DPKGJ-së dhe kryerjes së detyrave të saj, përndryshe ne mund të qëndrojmë këtu deri në ora 17;00 ose 18;00, nuk është problemi këtu por kishte me qene mirë që ju drejtoresh shpejt e shpejt të shkoni deri në zyre dhe të pyesni, a është në funksion vendimi i ish Kryeministrit z.Isa Mustafa apo i ish Kryeministrit z.Ramush Haradinaj pas gjendjes që është krijuar në mes Gjykatës Kushtetuese dhe Presidencës, e them këtë sepse ne në parim e mbështesim që prona të kthehet në pronë komunale absolutisht dhe kjo ka qenë kërkesë edhe e jona si subjekt politik si dhe vazhdimisht kërkojmë që zona industriale të përfundohet.

Jemi në dijeni po ashtu që deri në një pushtet tjetër pas zgjedhjeve që ishin as dokumentet nuk mund të rregullohen e lëre më çështja palestërre por duhet ta dimë se me cilin vendim të punojmë, duhet ta kemi të qartësuar, nëse e ka pezulluar vendimin ish Kryeministri z.Ramush Haradinaj për çështjen e kthimit të pronave në pronë komunale, juridikisht mbetet në funksion ish vendimi i mëparshëm.

Juridikisht edhe ne nëse marrim vendim jashtë ligjor, me vetëdije biem që jemi të pa përgatitur, e atë ne atë nuk guxojmë ta bëjmë, nëse është në funksion vendimi i ish Kryeministrit z.Ramush Haradinaj, me kërkesën e re ju vendoseni në votim unë e votoj për t'u kthyer kjo pronë në pronë komunale dhe me të fillohet me procedurat për këtë çështje, kur e them unë flas në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, nëse është në funksion vendimi i fundit i z.Ramush Haradinaj, nëse është i pezulluar apo nuk ka dritë të gjelbër nga organet shtetërore atëherë ne mbesim të abstenuar deri në vendimin juridik, pra kjo është përgjigja jonë si Grup.

z.Ragip Fetahu, theksoi, mendoj që kjo tematikë po del jashtë kontekstit sepse këtu është thjesht një gabim që është bërë nga procedurat e më hershme që janë zhvilluar nga kjo asamble, se çka ka bërë ish Kryeministri z.Isa Mustafa dhe çka ka bërë ish Kryeministri z.Ramush Haradinaj, kjo çështje i takon Qeverisë dhe nivelit qendror, por nuk na takon neve, e jona është ta përfundojmë këtë procedurë që i përket nivelit lokal, pra është një gabim i cili duhet të korrigjohet nga ne për të vazhduar me procedurat e mëtutjeshme. Nuk e di se a është lexuar mirë materiali me kujdesë edhe nga kolegët e mi asamblistë, mirëpo në material thuhet shumë qartë procedurat që për të vazhduar më tutje për caktimin e kësaj zone industriale duhet që t'i ndjekim procedurat, e para është korrigjimi i gabimit që është bërë nga pushteti i kaluar, këtë po e duamë asgjë më shumë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk desha të bëjë replikë por dëshiroj të jap një sqarim për kolegun z.Ragip Fetahu, edhe Kuvendet komunale, edhe çdo qytetarë në këtë Republikë duhet ta kuptojnë që punojmë me propozimin e projektligjeve dhe projektligjet që Kryeministri i përgatitë dhe i dërgon në Kuvend të Kosovës për miratim, pra Qeveria i bënë ligjet edhe për Komunën e Podujevës edhe për çdo Komunë tjetër, nuk më interesojnë autoritetet që po flitet këtu, besoj që brenda kësaj sale më së paku më interesojnë mua dhe nuk merrem me ata fare, vetëm kur përmenden më bije në mend ata, por problemi është që e kanë qenë në karrige dhe Kryeministri është ai e dërgon një ligj në Kuvend ashtu siç e ka dërguar tani ligjin për shuarjen e AKP-së, pra miratohen ato vendime dhe zbatimin duhet ta bëni ju, të pëlqeu apo nuk të pëlqeu, kurse problemi është që ai ka qenë Kryeministër i kësaj Republike, ndërsa a ka qenë Kryeministër perspektiv ose i aftë ajo është çështje tjetër që ne nuk mund ta vlerësojmë sepse edhe po të ishte i pa aftë nuk do të vinte në atë pozitë ngase disi e ka gjetur rrugën e zgjedhjes Kryeministër përndryshe do të ishte ndokush tjetër.

Nuk dëshiroj të thirrë ne popullizma sepse neve nuk na intereson çfarë po bëjnë ata por çfarë po bëjmë ne. Ky Kuvend ka miratuar një vendim për lokacion për palestër të sporteve, mirëpo të shkoj tani z.Shpejtim Bulliqi të vendos një lopatë beton aty, nuk mundet sepse është pronë e dikujt tjetër, prandaj këtu është problemi dhe që ne po kërkojmë sqarim, të na tregohet a është vendimi i qeverisë në funksion apo nuk është ngase i kemi dy vendime, nëse nuk është duhet të ndalet këtu kjo çështje sepse dëgjo këtu merret vendim dhe ai mund të jetë i jashtëligjshëm, përndryshe nëse është në rregull ky propozim unë votoj para juve që jeni në pushtet. Ne kemi kërkuar kthimin e pronave në pronësi të Komunës, por për këtë nuk po e dinë as drejtoresha e DPKGJ-së se cili vendim është në fuqi, ndërsa sipas një vendimi të qeverisë ka për të punuar pastaj ngase po të jetë ndryshe pastaj nuk do të na lejon AKP-ja për ato prona, sikurse që ka qenë rasti me palestrën sporteve e cila vetëm e ka dërguar një letër, dhe kur është caktuar prona është dalë të jetë pronë në emër dhe në menaxhim të AKP-së, prandaj sa i përket disponimit si asamble, sigurisht që të gjithë jemi që ato prona komunale të kthehen në pronësi komunale.

z.Agim Behluli, theksoi, e përkrahi atë zonë ekonomike, madje që 20 vite është dashur shumë më herët të bëhet por siç e kemi në princip në vetëm biem në gjumë, dhe pastaj kur të bëhet diçka dhe të fillohet me punime ndodhin gjëra tjera, e them këtë sepse aty me siguri se ka për të pasur konteste pronësore, kanë me na sjell letra prej dikujt jashtë Kosove të gjyshërve ose katragjyshërve atje, duke thënë ka qenë e këtij ose e atij sepse kështu ka ndodhur në gjithë Kosovën, madje jemi në dijeni shumë mirë të gjithë çfarë ka ndodhur në rrugën Prishtinë-Lipjan, e kujt ka qenë ajo pronë dhe qysh ka përfunduar, pastaj edhe në rrugën Prishtinë-Fushë Kosovë, dhe dyshoj se e njëta gjë ka për të ndodhur edhe në pjesën e pronave që po diskutojmë këtu për zonë industriale. Po ashtu për këtë çështje e marr si bazë edhe një vendim që është marrë para rreth 8 viteve apo ndodhat edhe më shumë sipas të cilit është ndarë një pronë për klubin futbollistik “Besiana”, nuk e di a është tërhequr ai vendim apo jo, për momentin ajo zonë është pasive, dikush ka mbjellë grurë, dikush misër mirëpo në çoftë se aktivizojmë në sot automatikisht do të sjellën letra këtu, prandaj do të ishte mirë që fillimisht ajo pjesë të pastrohet dhe të dihet se çka.

Unë e përkrah plotësisht dhe po më bëhet qejfi që qenka 37 hektar, janë 370 mijë metra katrorë, e di që nevojitet buxhet i lartë për tu bërë zona industriale sepse aty ka për tu bërë një rrugë re, një kanalizim i ri, një trafo e re, mirëpo ajo kërkohet prej kësaj ekonomie të zhvillohet, prandaj unë edhe njëherë po e përsëris se jam për, dhe se jemi vonuar 20 vite, mirëpo është mirë të shikohet infrastruktura ligjore se çka mund të bëhet, mos po na lajmërohen mbas 1 jave persona me dokumente, unë e përkrahi plotësisht dhe jam për atë që të bëhet ajo zonë industriale, por po e them infrastruktura ligjore të korrigjohet tamam siç duhet, në çoftë se fillojmë ne ta ndërtojmë atë zonë dhe tani ndokush në mes të asaj zone i sjell ndonjë dokument dhe na e prish komplet zonën, atëherë çfarë po bëjmë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, në këtu nuk po shkojmë në nivelin spekulativë se çka do të ndodh, në i kryejmë detyrën tonë si asamblistë, procedurat që na takojnë e që faktikisht me i korrigju dokumentet e të kaluarës që ka aprovuar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, janë edhe materialet aty dhe mund të shihen.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, e kam vetëm një pyetje sqaruese sepse këtu po del sikur dikush po dëshiron ta votoj e dikush jo, por pyes kush e menaxhon ngastrën 222 që kërkohet të ndryshohet në zonë industriale, a e menaxhon Kuvendi i Komunës apo e menaxhon AKP-ja, në emër të kujt është ajo pronë, pra këtu është problemi nëse parcela me numër të ngastrës 222 është pronë komunale me vendimin e ri të Kryeministrit z.Albin Kurti, këtu duhet miratim i AKP-së për tu përfunduar.

Në fillimisht në aspektin procedural është dashur t’i marrim pëlqimet, të mos keqkupton drejtoresha e DPKGJ-së sepse unë i pari i kam jap mbështetje për pikë të rendit të ditës dhe i jap sërish me u kthyer kjo pronë, por në është dashur t’i kthejmë letrat, këtu në Odë nuk jemi, por jemi në institucion ku punohet me dokumentacion, procedurë administrative dhe zbatim të ligjit, në të kundërtën kthehen mbrapa në pikën 0 nga dikush të kthen dhe merr kohë mandej. Nëse ngastra me nr.222 për të cilën DPKGJ kërkon të përfshihet ose korrigjohet, në duhet ta dimë se kush e menaxhon atë pronë, ngase atë që e tha këshilltari z.Agim Behluli që mund të ketë persona privat të cilët sjellin letra/dokumente të gjyshi apo ku ta dijë unë, nëse ngastra me nr.222 menaxhohet nga Komuna ajo punë kryhet lehtë, nëse menaxhohet nga AKP-ja duhet të kryhen procedurat përkatëse në mënyrë që trajtimi i pronës dhe kthimi të bëhet nga AKP, përndryshe në mund ta ngritim dorën sa herë që dëshirojmë por nëse nuk është dhënë dritë e gjelbër që ajo të votohet sigurisht se nuk mundemi.

z.Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomikë-DPZHE-së, theksoi, si drejtor i DPZHE ku nëse veç kalon votimi i sotëm në si Drejtori do të merremi me funksionalizimin e asaj zone industriale, mirëpo kam një pyetje për këshilltarët e Grupit të LDK-së dhe të gjithë të tjerët që e kanë votuar buxhetin në vitin e kaluar, a keni qenë të vetëdijshëm dhe a e keni lexuar që

në atë buxhet ka qenë i planifikuar një fond prej 30,000.00€ për funksionalizimin e zonës industriale, a i keni ditur gjithë këto dilema që i keni, a i keni pasur edhe atëherë dhe a e keni ditur që mund të keni konteste të tilla edhe atëherë apo jo, përndryshe është e pa kuptimtë nëse keni planifikuar buxhet vitin e kaluar dhe sot jeni kundër kësaj zone me gjithë atë fond që është bërë në buxhet.

z.Hasan Ajeti, theksoi, faleminderit z.Balaj sepse jeni protagonist edhe dihet pse, por nuk qëndron ajo që e potencuat, e para drejtoresha e DPKGJ-së e tha më herët se edhe në kohen sa ka qenë kryetar z.Agim Veliu ai e ka bërë një shkresë që ka pasur interes publik të komunës edhe drejtoresha e DPKGJ-së tha se sërish ia kam përcjell një shkresë por nuk kam marr përgjigje prej AKP-së, prandaj mos tento tani t'i japësh karakter politik për shkak të fushatës sepse askush nuk është kundër, mirëpo është legjitime prej anës time që vetëm ta di sepse keni sjellë në Kuvend, a i ke dokumentacionet përkatëse dhe kaq,. Unë i kuptoj njerëzit që nuk janë të fushës juridike, mund të mos i njohin materiet sepse të gjithë çka jemi këtu e dimë se të gjithë këto ligje që i nxjerr Kuvendi i Republikës së Kosovës ne punojmë dhe duhet të punojmë sipas tyre, prandaj të jemi shumë të sinqertë edhe me opinionin edhe me vetveten, në rast se është prodhuar një konflikt në mes dy institucioneve më të larta të shtetit, a ka një vendim tjetër, unë ju pyeta përgjigja e drejtoreshës së DPKGJ-së ishte që edhe përmes AKP-së nuk ka përgjigje. Ndërsa sa i përket asaj që tentuat ju me mjeshtëri t'i japësh element politik sepse e kuptoj drejtë që ke dëshirë të jesh një protagonist në mesin e këtyre 10 drejtorëve të nderuar që janë këtu, por e ke gabim (i drejtohet drejtorit të DPZHE) sepse në çiftë se nuk ka dokument ligjor harroje që mundesh me vendos ose të implementosh diçka, e them që çështja rreth kthimit të pronave është kontestuese, nuk është kontestuese interesi i komunës sepse askush nuk është kundër këtu as unë dhe asnjëri prej asamblistëve këtu.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE-së, theksoi, së pari përpjekjet që me i kthi diskutimet për çështje të komunës në rrafsh personal me mua, nuk kanë për t'ju ecuar asnjëherë sepse nuk e kam ndërmend personalisht me u marr me askënd. E dyta, pyetjen që po ia bënë drejtoreshës së DPKGJ pse nuk ia ke bërë ish drejtorit të drejtorisë përkatëse kur ju ka sjell buxhetin për miratim, pse nuk i ke thënë zotëri a i ke letrat mbase vetëm i ke sjell planifikimet për këtë zonën industriale.

Kaq po kërkoj ke planifikuar buxhet, pse nuk ke pyetur atëherë, a i keni letrat në rregull, pyetjen që po e bëni sot pse nuk e keni bërë atëherë dhe kaq, nuk ka protagonizëm këtu, për çështje shumë konkrete po kërkojë përgjigje konkrete.

z.Hasan Ajeti, theksoi, edhe njëherë po ta jap përgjigjen z.Pajtim Balaj, është legjitime pyetja ime, është e drejtë në aspektin kushtetues, e tani në kontest tjetër që e vendos ti ke merak në aspektin filozofik, përndryshe pyetja ime ishte profesionale, kështu që në pyetje profesionale me jep sqarime, vërtetë nuk merr vesh.

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ-së, theksoi, vetëm mbeta borxh me iu përgjigj këshilltarit z.Rafet Llapashtica sa i përket ngastrës kadastrale 222, në bazë të sistemit ne që punojmë në zyrën kadastrale komunale në Podujevë, ajo parcelë figurohet si pronë shoqërore nga kooperativa bujqësore, pra nuk evidentohet si pronë komunale.

z.Hak Rudari, theksoi, i dëgjuam me vëmendje edhe sugjerimet apo shpjegimet e drejtoreshës së DPKGJ-së, fillimisht dua të ju them se kam qenë pjesë e grupit të këshilltarëve të Kuvendit edhe në mandatin 2013-2017 dhe për këtë çështje në parim edhe atëherë i kemi dhënë përkrahje për arsye se Grupi i LVV-së edhe atëherë edhe tash kërkon investime dhe përkrahje çdo investim që është në interes të qytetarëve. Duke u nisur nga ajo që tha drejtoresha e DPKGJ, duke e përcjellë pra këtë përmes mediave, Gjykata Kushtetuese nuk e ka shfuqizuar në tërësi, kjo mbetet se vendimi i ish Kryeministrit z.Ramush Haradinaj mbetet në fuqi dhe përgjegjësinë për zbatimin e vendimit të ish Kryeministrit z.Ramush Haradinaj e ka Qeveria aktuale, kurse ne si Kuvend i Komunës, tani po flas në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim dhe kërkojmë që kjo çështje të vihet në votim në mënyrë

që të ecim tutje, përndryshe sa i përket zonës industriale në parim vërtetë jemi të gjithë për investime prandaj për këto investime është mirë që ne si Kuvend t'i japim dritën e gjelbër sepse për atë dhe i kemi marr votat e qytetarëve. Pra në emër të Grupit të LVV-së kërkoj të hedhet në votim në mënyrë që kjo çështje të kalojë pastaj në procedurat tjera.

Sa i përket asaj që u cek rreth procedurave se a ka probleme pronësore ato janë tjera dhe ato merren instanca tjera, nuk është Kuvendi i Komunës, por janë Gjykatat, janë Inspeksionet, Drejtoritë, kurse neve si Kuvend na mbetet vetëm të votojmë për apo kundër kësaj pike që është sjellë për diskutim, prandaj po them ne dëshirojmë të hedhet në votim dhe të vazhdojmë tutje.

z.Agim Behluli, theksoi, sa i përket shumës prej 30,000.00€ që qenka planifikuar, atë vend aty me atë shumë buxhetore as me matë nuk mundesh e lëre më të punohet diçka në të. Unë vijë nga ajo pjesë dhe e përkrahi zonën ekonomike, madje kështu shumë hapur dhe për këtë jam njëri prej atyre që këtë e kam kërkuar qysh në vitin 2000 ku kam thënë se gjëja e parë që duhet të bëhet në këtë vend duhet të bëhet zona ekonomike, ne nuk e kemi bërë atëherë, jemi vonuar 20 vite.

Unë jam për ta bërë zonën ekonomike kudo që bëhet (Llapashticë apo kudo qoftë), vetëm të bëhet ndokund, po në çoftë se na fillojmë ta bëjmë dhe ndajmë buxhet dhe i marrim parat dhe dalim para dikujt dhe themi po e bëjmë, dhe pas 3-4 viteve që të vendoset mund të vijë dikush që të na thotë nuk mundeni me hap, prandaj këtë nuk po e di dhe është mirë të na sqaroni.

Personalisht ndoshta jam në gjendje edhe të ndihmoj edhe në shumë gjëra tjera vetëm të bëhet, sepse ne e dimë aty duhet të vendoset trafo, kanalizim, ujë, duhet të bëhet edhe infrastrukturë, menaxhim i mbeturinave dhe çështje tjera të nevojshme sikurse që është bërë Fushë Kosovë, por problemi është tek prona dhe këtë duhet ta kuptoni, dhe për këtë jemi dijeni se problemi më i madh në gjithë Kosovën është me prona, e ceka më herët se jemi në dijeni çfarë ka ndodhur me pronat në rrugën Prishtinë-Lipjan, të gjithë ato fusha e dimë të kujt kanë qenë e si janë bërë. Ato prona kanë qenë pronë e kooperativës, madje unë si nxënës kam punuar, unë si nxënës kam punuar në ato ara, mirëpo problemi është që janë 370000 m², dhe të mos t'i dal Komunës ndonjë problem rreth tyre, shembull, nuk e di çka është bërë me pronën që i është klubit futbollistik "Besiana" a është në kuadër të kësaj zone apo jo. Për fund, ne jemi dhe e mbështesim bërjen e zonës industriale, madje edhe për t'ju ndihmuar juve si Ekzekutiv.

z.Florent Hasani, theksoi, ne nuk mund të ngecim për arsye të frikës se do të vijë ndokush dhe ta kontestoj pronën në ato pjesë sepse çdo pronë mund të kontestohet dhe është e diqshme kjo që në baza ligjore bëhen këto çështje, prandaj kërkojmë edhe njëherë që të hedhet në votim kjo pikë e rendit të ditës, besoj që dokumentacionin e kemi të mjaftueshëm, të bëhet korrigjimi i atij gabimi dhe të vazhdojmë tutje me procedura tjera.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj që u stërzgjatë kjo pikë për shkak të pamundësive, PDK e mbështet qëndrimin që prona të kthehet në pronë komunale dhe të ndërtohet zona industriale, mbetet përgjegjësi e DPKGJ-së të zhvillojë procedurat tjera, mirëpo që as në të kaluarën nuk ka marr përgjegjësi askush për ato përzierjet në prona siç e ceku z.Agim Behluli, e që të njëjtat po vazhdojnë edhe tani në mënyrë hipotetike mirëpo që nuk mund të themi se do vazhdon apo jo, është çështje kohe. As çështja e pronës së ndarë për klubin "Besiana" as për zonën industriale as për palestrën sportive, sepse këtu problemi është që kush është në pushtet nuk merr përgjegjësi dhe kjo dëshmohet duke mos u deklaruar për një gjë të tillë, dhe tani çfarë të bëjmë ne që këto veprime nuk janë ndërmarrë për 20 vite, përgjegjësi ka dikush që ka qenë në karrige udhëheqëse aty, madje askush nuk merr përgjegjësi pse prej vitit 2010 dhe tani jemi në vitin 2021 ngastra e cekur është gabim, ne nuk mund të dalim dhe ta ekzekutojmë ish drejtorin pse ka pritur kur qytetarët janë duke prituri këtë institucion çka po bënë për këtë zonë.

Dorën në zemër, njerëzit e lajthitur janë duke i gënjyer qytetarët, ata kanë pritur që ka për të pasur shërbime spitalore, rinia ka pritur që ka për të stërvitur në palestër sportive, të tjerët kanë pritur që ka për të ndërtuar biblioteka e re që thoshte kolegia këshilltare z.Doruntina Hasani, të tjerët që janë bizneset kanë pritur që të hyjnë në zonën industriale, kurse ne sot mund shikojmë se çfarë të bëjmë me rregulloren për bizneset dhe gjëra të ndryshme, kështu që le të hedhet në votim, Grupi i PDK-së në parim e mbështet që prona në fjalë të kthehet në pronë komunale dhe pastaj proceduralisht i mbetet në përgjegjësi të DPKGJ-së se si do ta zgjedhë këtë problem me institucionet.

z.Hasan Ajeti, theksoi, edhe njëherë pop e them që askush nuk e konteston interesin e Komunës për këtë pikë, vetë fakti që është diskutuar afër 1 orë kjo temë, domethënë vjen si rezultat i prodhimit të vendimeve që kanë ardhur dhe përgjigjes që ende nuk e ka marr drejtoresha e DPKGJ-së prej AKP-së. Unë po e them edhe qëndrimin e Grupit të LDK-së, është në interes të Komunës por duhet të ketë një pastërti të kthjellhtë, të çartë dhe koncize që nesër mos të ketë telashe.

Tani po flas prej këndit politikë, jo si jurist, ka telashe aty sepse vet fakti që është hap ky diskutim ka telashe, pyetjet që ju adresova juve drejtoreshë e DPKGJ-së e që përgjigje si duket nuk keni marr as ju, në çoftë se ndokush thotë këtu se nuk është problem, organi kryesor që merret me këto prona atëherë ai nuk e ndjek më tepër, prandaj ne po abstenojmë për këtë çështje, është përgjegjësi e juaja drejtoresh e DPKGJ që nesër të merresh me këtë materie, mirëpo unë po ta them shumë miqësisht sepse nuk është shumë e pastër ky problem nuk është i lehtë.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht dy propozim vendimet përkatëse të Kryetarit të Komunës, të cilat janë të përfshira brenda kësaj pike.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit i konstatoi se me 20 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, dhe 15 vota të PËRMBAJTURA, miratohen;

- Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.prot.01/148-350 datë 29 prill 2010, për caktimin e Zonës Industriale në fshatin Livadicë;

- Propozim Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.prot.01/60-02 datë 28 mars 2013, për përcaktimin në interes publik të një pjese të tokave të ish Ndërmarrjeve Shoqërore në territorin e Komunës së Podujevës,

sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa

2. Propozim Rregullorja për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës.

- Raporti nga mbajtja e diskutimit publik

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ-së, theksoi, bazuar në Ligjin 06/L-092, pika 6 e Rregullores (QKR) 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës përkatësisht nenit 7, Komuna ka të drejtë të dhënies në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës për më pak se një vit. Ashtu siç edhe jeni të informuar përmes raportit mbi diskutimin publik DPKGJ në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, si dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, kemi mbajtur shqyrtim publik më 23 mars 2021 dhe ashtu siç jeni të njoftuar përmes raportit mbi diskutim publik material të cilin besoj që ju e keni marr me kohë dhe e keni para vetës, andaj të nderuar asamblistë kjo

rregullore është e rëndësishme dhe e njëjta është hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe kërkojmë votën tuaj për shprehjen e interesit publik të Komunës sonë.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i asamblastëve të LVV-së duke e ditur përfitimin që e merr Komuna nga shfrytëzimi i këtyre hapësirave, e mbështesim këtë propozim rregullore vetëm kërkojmë që t'ju përmbahen kriterëve, kushteve dhe procedurave.

z.Hasan Ajeti, theksoi, e nderuara drejtoreshë e DPKGJ-së, edhe në diskutim publik që ka qenë kjo rregullore ka pasur disa këshilla dhe sugjerime nga ish drejtori i DPKGJ-së, mirëpo ju jeni thirrur që drafti është përgatitur nga ekspert të fushës në bashkëpunim me përfaqësues të MPL-së dhe është po thuajse e ngjashme me të gjitha Komunitet tjerë, a ka mundësi vetëm të na jepni sqarim rreth kësaj.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, unë mendoj që të gjitha parimet, kriteret dhe procedurat janë përfshirë në këtë rregullore për dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme komunale, prandaj për këtë arsye unë mendoj se është në rregull dhe ne Grupi i këshilltarëve nga PDK do ta mbështesim.

z.Adnan Zymeri, theksoi, me raportin mbi diskutimin publik që është bërë në lidhje me këtë rregullore ju e nderuar drejtoreshë e DPKGJ-së keni thënë se kanë marr pjesë 27 qytetarë dhe ata qytetarë e kanë falënderuar Komunitetin se ka qenë shumë transparente në diskutimin për këtë rregullore, mirëpo vetëm desha të të tregoj që kjo nuk ka të bëjë fare me transparencë, pjesëmarrja e qytetarëve është obligim dhe ju nuk keni faj sepse herën e kaluar asamblastët e LVV-së, na kanë akuzuar neve dhe kanë thënë që diskutimet publike lidhur me rregulloren të tilla bëhen pa pjesëmarrje të njerëzve, pastaj ju e keni shkruar se 27 persona kanë marr pjesë, por në të kaluarën Komuna i ka publikuar në ueb faqe zyrtare fotografitë dhe ka treguar pjesëmarrjen e qytetarëve nëpërmes fotografive. Përveç kësaj sa i përket përmbajtjes së rregullores kisha dashur ta di prej drejtoreshës pse mendon që rekomandimi që e ka jap z.Abaz Llugaliu për nenin 2 nuk duhet të përfshihet.

znj.Bahrie Mehmeti, drejtoreshë e DPKGJ-së, theksoi, ne kemi pasur udhëzues praktik të kësaj rregulloreje e cila është bërë për herë të parë në nivel lokal të gjitha komunave. Sa i përket pyetjes për nenin 2 pse nuk e kemi parë të arsyeshme me e inkorporuar në rregullore, arsyeja ka qenë se të gjithë personat e Komunës së Podujevës kanë të drejtë të aplikojnë për këto prona, pronat ipen më pak se një vit, zakonisht janë hapësirat publike, sheshet, parqet, bulevardet, kjo nënkupton që ato hapësira ofrohen për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe kjo është arsyeja pse e kemi lënë në këtë formë domethënë ta aplikojmë të gjithë. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga organet e Komunës, personat fizik, juridik dhe të gjithë që janë qytetarë të Komunës së Podujevës sepse është rregullore e brendshme e Komunës.

z.Adnan Zymeri, theksoi, arsye pse janë refuzuar propozimet dhe sugjerimet përkatës keni thënë se është përafërsisht e ngjashme me tërë territorin e Republikës së Kosovës, kjo i bije që edhe specifikat e Komunës së Podujevës janë të njëjta me të gjitha specifikat e Komunave tjera në nivel të Republikës, prandaj po them që kjo gjë është gabim dhe mendoj që të gjitha rekomandimet që i ka dhënë z.Abaz Llugaliu duhet të përfshihen në rregullore.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht propozim Rregulloren përkatëse sipas raportit nga diskutimi publik.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 15 vota ishin PËR, 16 vota KUNDËR dhe asnjë votë të PËRMBAJTUR, nuk miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

3. Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës **- Raporti nga mbajtja e diskutimit publik**

z.Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, do të flas për raportin e debatit publik, e para në këtë çështje më vije keq që kanë munguar këshilltarët komunal, asnjë prej këshilltarëve komunal nuk ka marr pjesë në debatin me qytetarët dhe me bizneset që e kemi mbajtur, ku kanë marr pjesë 30 përfaqësues të bizneseve dhe të shoqërisë civile, 19 nga ta kanë participuar më pas me ide dhe propozimet e tyre.

Gjatë një muaji sa ka zgjatë periudha e dëgjimit kanë ardhur edhe 13 propozime përmes e-mailit, janë përmendur peticione të ndryshme dhe gjatë kësaj periudhe mua si drejtor nuk më ka ardhur asnjë petition dhe asnjë propozim në mënyrë të organizuar, kryesisht të gjitha kanë qenë individuale, janë bërë disa ndryshime dhe prej draftit të parë që e kemi propozuar para rreth 1 muaji të cilat kanë të bëjnë me disa pika, të gjithë i keni materialet dhe besoj që është e rëndësishme me u sqaru për qytetarët që na ndjekin se çka është propozimi ynë, më konkretisht pika më e ndjeshme është ajo që lidhet me nenin 6 që ka të bëjë me orarin e punës të dyqaneve ushqimore, maketeve dhe qendrave tregtare, ndryshimet që janë bërë në harmoni me kërkesat e bizneseve në njërën anë të punëtorëve dhe të qytetarëve të cilët që kur e kemi marr detyrën në vazhdimësi kanë kërkuar që të gjendet një zgjidhje dhe të hapet e diela, përpjekja jonë ka qenë që të gjejmë një zgjidhje një farë harmonie në mes të këtyre kërkesave, rrjedhimisht kemi propozuar që ditën e diele të punohet gjithë ditën për bizneset që furnizojnë me produkte ushqimore në hapësirë deri në 50 m², hapësirë të brendshme të dyqaneve.

Orari i ditëve të rregullta të javës për sezonin e verës është zhvendosur nga ora 22:00 në ora 23:00, është reduktuar numri i festave zyrtare të cilat me rregulloren aktuale çdo festë zyrtare është llogaritur festë zyrtare me rregullore e që është dashur që të pushojnë bizneset, nuk është respektuar kjo gjithëherë prej bizneseve mirëpo rregullorja e ka përcaktuar kështu, nëse miratohet kjo draft rregullore festat zyrtare për bizneset do të konsiderohen Viti i ri, Pavarësia dhe Bajrami i Madh dhe i Vogël, siç ka sugjeruar që t'i referohemi Bajrameve njëra prej këshilltarëve në një prej seancave të kaluara. Është inkorporuar në rregullore edhe shërbimi i veterinarisë, dhe kozmetikës prej orës të cilat janë të lidhura me veprimtaritë e salloneve të ondulimit të cilat veprimtarinë më të madhe punojnë gjatë verës.

Unë ju bëj thirrje ta votoni këtë rregullore sipas raportit nga diskutimi publik dhe sipas materialit përkatës sepse besoj që është një zgjidhje e mirë dhe e drejtë dhe ndikon në mbajtjen gjallë të zinxhirit të furnizimit të qytetarëve në ditën e diel. Ne jemi në dijeni se kemi shumë qytetarë të cilët jetojnë në Prishtinë, Fushë Kosovë dhe në komunat tjera dhe ata kryesisht kthehen ditën e diele dhe është e rëndësishme që ne të mendojmë edhe për këtë pjesë të qytetarëve që nuk janë në numër të vogël. Kemi menduar edhe për ekonominë tonë, mendojmë edhe për bizneset e vogla që janë shumicë, ata na kanë votuar të gjithë neve dhe kemi ardhur këtu t'i përfaqësojmë ata dhe është shumë e rëndësishme që sot bëhet dallimi mes grupeve të interesit dhe interesit të qytetarëve, ose jemi për interesin e qytetarëve ose për grupe të vogla të interesit që mund të jenë pak.

z.Hasan Ajeti, theksoi, është përgjegjësi i Ekzekutivit që e përfaqëson z.Pajtim Balaj në cilësinë e drejtorit të DPZHE dhe në cilësinë e iniciuesit të ndryshimit të kësaj rregulloreje sepse një temë mjaftë me rëndësi dhe në bashkërendim me bizneset e gjejmë mundësinë më të mirë për organizimin e orarit të punës përmes plotësim ndryshimit të rregullores përkatëse. Ndryshimet e bëra zotëri Balaj vetëm sa e kanë thelluar hendekun në mes të dyqaneve ushqimore ku bëhet një prerje në mes atyre që ju i cilësoni si të vogla me 50 m² dhe të tjerave të mesme apo të mëdha, pra

me këtë propozim ndryshim dhe këtë “ide brilante” tuajën ju vetëm keni çrregulluar orarin e punës dhe nuk po bëni zgjidhje por po i vendosni në atë pozicion bizneset që janë në rrugë pa dalje, përtej kësaj i jepni vetvetes dhe i kualifikoni në aspektin politik se kush është me biznese të mëdha dhe kush me të vogla, kështu që vëreheni që jeni kundër ekonomisë së tregut të lirë si term pak i kompleksuar por tani nuk po i shihni se në mesin e tyre jeni edhe ju. Nuk është e drejtë dhe parimore pa i harmonizuar qëndrimet me bizneset të sillni për herë të dytë këtë rregullore për miratim në Kuvendin e Komunës. Unë e kam këtë peticion si gjithë të tjerët me 60 nënshkrime të bizneseve që janë kundër, por tani kemi edhe një informatë/material që bizneset e mëdha janë pro që të punojnë ditën e diele, është mirë që ju si pushtet që është edhe përgjegjësi ligjore e juaja por edhe ju si pjesë e këtij ndryshimi të madh epokal që po e bënë me ato idetë brilante, me gjet së pari një ujdë me këto biznese dhe nesër pastaj mos me na sjell këtu në këtë pozicion asnjë Grupi të këshilltarëve të subjekteve politike që përfaqësohen në këtë Kuvend të kualifikohen kinse ti je për, e ti kundër, edhe me marr të drejtën tani klasën punëtore që atë të drejtë e mbron ligji dhe në mesin e tyre që ka jap vlerësim për të mos punuar ditën e diele e ke edhe këshilltarin e nderuar z.Kasib Bashota i cili ka qenë kundër e që vije prej LVV-së, kështu që shihet që as harmonizimet apo qëndrimet politike ju nuk i keni ne vijë me subjektin politik që e përfaqëson.

Gjykojë që është normale të dëgjohet dhe respektohet edhe pala tjetër, në këtë rast bizneset sepse tek e fundit e ke edhe obligim ti trajtosh si palë në marrëveshje, përndryshe ju keni bërë vetëm ndryshime, prandaj ne Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së do votojmë për, vetëm atëherë kur ju t'i harmonizoni qëndrimet me bizneset, në të kundërtën ju keni prodhuar telashe, këto telashe duhet me i zgjedhë ju vet, (ju po e luani rolin sikur të atij peronit kur shkuan palët në procedurë tha jeni në kontest për një pronë, i thuhet jeni mirë dhe në këtë rast e keni të dytë mirë dhe zgjidhja ishte zero) prandaj nuk mund ta luash atë rol i nderuar drejtor por dil këtu në foltore, ke marr përgjegjësi dhe ke kompetencë sepse rreth asaj që po aludohet se dje ka qenë keq, sot e ke marr ti pushtetin dhe mirë është, por mos tentoni tani ju këtu me na hedh neve këtë si pjesë të Kuvendit që ne jemi ata që nuk po i japim dritë jeshile sepse fundja ne i miratojmë vetëm kur ka harmonizim, por këtu popullizëm mos bë në politik. Ju po flisni në emër të Ekzekutivit si palë dhe në anën tjetër bizneset, këtu e ke këtë peticion dhe unë nuk po e marr si të kryer që të gjitha peticionet mund ta përfaqësojnë Komunën e Podujevës.

Edhe në kohën kur ka qeverisë LDK-ja kemi pasë një kërkesë prej një OJQ-je në fshatin Orllan e që ajo pjesë duhet të trajtohet dhe më tepër për shkak të specifikave, por tani me këtë propozim ndryshim të kësaj rregulloreje ka mundësi që edhe në disa sektorë tjerë të intervenohet. Nuk po e marr të drejtën me cilësu, me të drejtë ose pa të drejtë, mirëpo vetëm e them se përafërsisht kjo është përgjegjësi e juaja, ju keni qenë kryesues dhe ju duhet t'i bëni zgjidhjet.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, këtij dokumenti që është sjell sot në Kuvend propozojmë që t'i shtohet edhe një rekomandim që ka të bëjë me dyqanet ushqimore të vogla të cilat janë të rrezikuara nga supermarketet. Pra kërkojmë që brenda metrazhit që e përcakton DPZHE bizneseve të vogla t'ju mundësohet që me lëshimin e një leje të posaçme të kujdestarisë edhe gjatë natës, sigurisht me një pagësë simbolike në këtë mënyrë që ato biznese që kanë vullnetin të kujdestarojnë do ta kenë mundësinë që t'i kompensojnë edhe humbjet që u shkaktohen gjatë ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, e dëgjuam edhe propozimin e drejtorit të DPZHE dhe diskutimet e më herët, të gjithë e dimë që rregulloret dhe udhëzimet duhet të nxirren komform ligjit, ne duhet të bazohemi diku për ta rregulluar një fushë specifike ashtu siç po dëshiron drejtori i DPZHE për çështjen e bizneseve në Podujevë. Në parim konsideroj se edhe herën e kaluar ka qenë keq me ish drejtorin z.Mirsad Kamerolli që është marr me këtë tematikë të ngritjes fillimisht prej z.Agim Bahtiri (Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut), prej një kryetari tregtar kafshësh i cili e ka

vendos një rregullore të cilën e ka përgatitur me dikën dhe tani të gjitha Komunat shikojnë e veprojnë në atë mënyrë se kënd ta bllokojmë, kënd ta lëm të punoj. Kjo që po e them është e vërtetë sepse vetëm 3 Komuna merren me këtë çështje. Propozimi i drejtorit të DPZHE ishte tani që të punojnë lokalet që janë deri në 50 m², pyes ku jeni bazuar ju drejtor i DPZHE-së që vetëm kush i ka 50 m² mund të punojë në territorin e Podujevës, dhe tani ndonjë biznes që i ka 50.5 ose 51 m² nuk ka drejtë të punoj.

Ju kanë votuar qytetarët juve më shumë 52%, përgjegjësinë nuk e ka opozita për këtë problem që është me bizneset në Podujevë, këtë duhet ta jap pushteti, Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi i cili duhet të kërkoj prej drejtorit të gjen zgjidhje për zhblokimin apo bllokimin e bizneseve ditëve të diela, pra Kryetari e ka fjalën kryesore edhe pse nuk është prezent këtu por që është prezent Nënkryetarja e Komunës e cila duhet të del në foltore dhe ta thotë qëndrimin e Ekzekutivit për orarin e punës së bizneseve ditëve të diela, pastaj le të marr përgjegjësi LVV-ja, Nënkryetarja në këtë rast sepse Kryetarin e Komunës nuk po e përmend sepse kur nuk është prezent nuk e përmendi askënd, pra si Ekzekutiv ta potencon qëndrimin për bizneset e Komunës së Podujevës dhe pastaj ne do të ta shohim reagimin e votës politike në Kuvend, mirëpo sa e di unë qëndrimi i Kryetarit ka qenë i kundërt me atë të drejtorit të DPZHE sepse ka thënë unë jam për të punuar edhe të dielave ngase po më duhet të shkoj në fshatin Lupç të blejë diçka, pra kështu ka thënë në një prej seancave të kaluara. Çështja tjetër, drejtori i DPZHE e tha se ka pasur 13 kërkesa prej bizneseve, mirëpo unë i kam 105 kërkesa këtu i nderuar drejtor z.Pajtim Balaj, janë me nënshkrim dhe me vulë të bizneseve të dorëzuar prej përfaqësuesit të bizneseve të Podujevës, pra i kam 105 kërkesa, nëse më i kanë jap ata vetëm ashtu, ata mbajnë përgjegjësi sepse unë zyrtarisht po flas me vulë të biznesit me emër të biznesit me drejtor të kompanisë, kurse ju drejtor i DPZHE-së ke biseduar me 13 të tillë, ndërsa unë opozitë me 105, ju nuk jeni askund, pa dashur t'ju akuzoj politikisht, 105 biznese të Podujevës në nivel Komune e që me këtë punë nuk është merr as z.Shpejtim Bulliqi sepse ai kur të sjell në rend dite këtu me nënshkrim te tij ai, duhet t'i kaloj propozimi nëse e ka mirë, ose në këtë rast Nënkryetarja që po e vëzhgon seancën e Kuvendit të Komunës, mund të jap ndonjë përgjigje e që asnjë drejtor nuk mund ta jap.

Tani këtyre 105 bizneseve duhet me ua jap një përgjigje zyrtarisht sot, kërkesave të tyre po flas sepse në Podujevë unë kam kërkuar disa herë ta dijë sa biznese janë të regjistruara që paguajnë tatim dhe ato siç e dimë që janë disa ekonomi familjare që funksionojnë ku mund të jenë 700-800 disa prej tyre ndoshta janë fiktive, por po e them janë 500 të tilla, prandaj e them se këto 105 biznese që unë e posedoj kërkesën e tyre me të cilën, shembull, që mundësisht dita e diel të jetë pushim sepse ne e kemi bërë për t'i zhbllokuar bizneset, dhe ne nëse thirrëmi në votën qysh e tha drejtori i DPZHE, atëherë për ne nuk është problem vota fare, as fare a jemi ne në këtë mandat këtu sepse ish drejtori z.Mirsad Kamerolli e ka sjellë një rregullore kurse tani ke ardhur ti drejtor, por asnjëri nuk keni mund t'i jepni përgjigje këtij problemi. Nuk mund të punohet në komunë nga askush vetës pse dëshiron ai apo unë, pa asnjë ligj sepse atë formë nuk e lejon rrethi. Pra tani këto 105 biznese që mua më kanë dorëzuar kërkesën që dita e diel të jetë ditë pushimi dhe ditëve tjera të punohet deri në ora 23:00, ose me u hap të gjitha, kurse po të ish marr një vendim sipas të cilit do të rregullohej funksionimi i ushqimoreve, funksionimi i gastronomisë, por nuk do të funksionojnë lokalet e natës, shisha-baret dhe diskotekat, këtu ne do ta analizonim cili është interesi i shoqërisë këtu, do ta fuqizonim inspektoriatin.

Çështje tjetër, kjo rregullore e drejtorit të DPZHE z.Pajtim Balaj dhe atij drejtorit të z.Agim Bahtirit që e ka vendosur këtë temë, është dashur që të mbetet në funksion Ligji i Punës, ligj i cili është trajtuar nëpër komisione, kanë propozuar Kryeministra, Deputet, dhe është i miratuar, dhe ne Podujeva tani a të punojmë me rregulloren që dëshiron ti drejtor dhe Kryetari z.Shpejtim Bulliqi

apo siç ka dashur ish Ekzekutivi, apo të punojmë sipas Ligjeve që janë të miratuara në Republikën e Kosovës, si t'ia bëjmë tani apo po dëshiron propozimin tim apo çfarë dëshironi, mirëpo kush jemi ne këtu me jap propozime pa bazuara në ligj, kush ju jep të drejtë juve drejtor të ndash lokalet mbi apo nën 51 m² dhe pastaj t'ju thuash ti ke drejtë ti jo të punosh. Ne nuk jemi të mos ndryshohet Rregullorja, madje unë edhe më herët e kam thënë dhe kam kërkuar nga ti drejtor që të marrësh një komision dhe t'i vizitoni gjitha bizneset dhe të merresh mendimin e tyre e pastaj ta sjellësh në Kuvend, por sërish nuk ke lëvizur prej zyre ashtu sikurse që ke vepruar në seancën e kaluar, vetëm i ke pritur 13 e-maile, kurse unë si asamblisti dhe opozitë i kam 105 kërkesa, prandaj përgjigja jonë si opozitar është abstenimi, ngase nuk mund të jap përgjigjen e 52%-shit nga zgjedhjet e fundit, përgjigje të jap z.Shpejtim Bulliqi me elektoratin e tij, si përgjigje e qytetarëve i cili gjithashtu nuk mund të më thotë mua përse më keni penguar, e them këtë sepse ju po kërkonit ta hidhni përgjegjësinë te opozita e që në këtë rast Grupi i PDK-së vetëm do të rrijë dhe shikoj dhe t'ju thotë të tjerëve shikoni qeverisja e re me z.Shpejtim Bulliqi si Kryetar i Komunës së bashku me drejtorin e DPZHE-së. Cili është qëndrimi i LVV-së dhe i z.Shpejtim Bulliqi për bizneset në Podujevë, më tregoni ndokush, a jeni për t'i liruar apo për t'i diferencuar apo jeni për t'i bllokuar ashtu siç është aktualisht, dhe tani këtë përgjegjësi nuk e merrni por shikoni se si po voton PDK-ja, a po e bënë shumicën apo jo, ndërsa ju them se ne nuk e bëjmë shumicën, për mua 105 biznese janë më shumë se 13 biznese të drejtorit që ka marrë e-maile prej tyre, ngase ata e dinë që unë jam opozitë dhe nuk jam drejtor këtu sikurse drejtori i DPZHE që të nënshkruaj dhe të cilit i mungon komunikimi me Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqi sepse Kryetari ka thënë se nuk është e mirë rregullorja dhe për atë arsye jemi ardhur këtu ku jemi, mendimi i Kryetarit ka qenë mos me u bllokuar bizneset, kurse e jotja drejtor është tani në kontrast me atë, prandaj ne si Grup i PDK-së jemi që të lihet në funksion Ligji dhe Udhëzimet e miratuara për bizneset, Ligji i punës për punëtorët e sektorit privat, ndërsa të kryhen obligimet ligjore në Komunë sa i përket orarit të punës, pra të definohet qartë. Shembull, sipas propozimit market "Egzonita" nuk mund të punoj ndërsa një market tjetër i njëjtë të punoj të dielave kur kemi parasysh që të dyja janë ushqimore ta zëmë, prandaj i nderuar drejtor i DPZHE ndoshta dikujt i duket vetëm pse jemi opozitë po e themi një gjë të tillë, shumë jam i bindur që në këtë rast ku nuk është prezent Kryetari, askush nga LVV përfshirë edhe Nënkryetaren nuk mund të dal në foltore dhe të jap përgjigje problemit në fjalë, të paktën ta thotë ne si udhëheqje komunale deri në tetor ku janë edhe zgjedhjet e ardhshme pavarësisht a fitojmë si LVV apo jo, si udhëheqje komunale do të punojmë me këtë problematikë, nëse mundeni ndokush dilni t'ju dëgjojnë qytetarë, dhe ne pastaj ju japim përgjigje sepse ju themi vazhdoni ju me këtë propozim, pastaj vota është ashtu siç i'u bie më mirë secilit, mirëpo ti drejtor mos sjell propozime të tilla këtu në asamble sepse ne disa jemi opozitë dhe nëse ju pritni çdo ditë ne të vijmë dhe t'ju tregojmë se çka të bëni ju atëherë duhet të liroheni nga detyra, mos e merr personale ti drejtor këtë, fjala është për një drejtor të DPZHE-së i cili ulet në karrigen e drejtorit e nuk din të nënshkruaj pa u pajtuar qytetari në këtë letër, prandaj nuk mund të shkruash gjithçka në letra, ndoshta edhe e shkruan sepse nuk ta kundërshton askush, por ti drejtor duhesh të jesh ai që duhet të thoni po ose jo. Këtu në asamble jemi 35 këshilltar dhe secili kemi mendime të kundërta, ndërsa në rast se pyetemi politikisht ashtu siç po kërkon ti drejtor të bësh 18 vota për e andej të mbeten 16 kundër ashtu nuk mundesh, ose të deklarohen secili për votën e vet, të thotë votat i kam nga subjekti PDK ose LDK ose AAK kurse tani e kam një interes dhe po shkoj në LVV, pra edhe nëse ndonjëri vepron në këtë formë ai/ajo do të dihet publikisht kush është dhe si po voton, e them këtë edhe pse nuk i mbështes presionet politike.

Si do që të jetë i nderuar drejtor z.Pajtim Balaj, ju lus miqësisht të analizoni me gjakftohtësi këtë rregullore për shkak se edhe ne si opozitë kemi kërkesë, analizoni me ekspert të fushave dhe ke

me u bind qe ju e keni keq me ato mendimet siç i ke bërë apo me atë propozimin e këshilltares z.Lirika Maliqi që ta obligoni ndonjë biznes privat për të kujdestaruar por nuk mund ta bësh atë gjë sepse në ekonomi të lirë të tregut kapital nuk mund ta obligosh askënd, një gjë të tillë e bëjnë vetëm vendet moniste, me programe të diferencimit, nuk mund ta vendosesh ti një ligj/rregull se kush të punoj e kush jo, i vendos për momentin sepse siç duket ne jemi duke shkuar në një drejtim tjetër edhe si Komunë, por ne duhet ta lëmë ekonominë e lirë të tregut, duhet të zbatojmë ligjin, madje gjithë rregulloren ke mundur ta vendosesh në funksion, vetëm me një kërkesë për Drejtorinë e Inspeksionit dhe t'i kërkonit zbatimin në përpikmëri të Ligjit të punës dhe Ligjit që ee reegullon tregtinë e brendshme apo funksionalitetet e bizneseve sepse inspektorët edhe të dielave janë në detyrë zyrtare, e pastaj edhe votat do të ishin njëzëri në këtë Kuvend.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, sa i përket rregullores për orarin e punës së bizneseve mendoj që është një çështje shumë e ndjeshme dhe nuk duhet të bëhet praktikë që çdo drejtor qe ndërrohet të ndërrohet edhe kjo rregullore sepse kjo i prek direkt qytetarët e Komunës së Podujevës.

Unë mendoj që duhet me mendu më shumë këtë çështje dhe me marr një vendim i cili është i përshtatshëm për të gjithë për shkak se nuk po e shoh të arsyeshme qytetarët e Komunës me dalë të dielave në një Komunë tjetër për t'u furnizuar me produkte ushqimore, aq më pak nuk po mund ta kuptoj dhe jam duke e analizuar disa herë se si mundemi ne t'i kushtëzojmë bizneset me m^2 , çka nëse dy lokale afër njëra tjetrës njëra është $50 m^2$ e tjetra $55 m^2$, për $5 m^2$ njëra ka të drejtë të punojë ndërsa tjetra nuk ka drejtë të punojë, dhe pyetja shtrohet a të obligohet tani biznesi që ta zvogëloj apo me mbyll lokalin, si të me vepro. Mendoj që duhet ta mendojmë gjatë këtë çështje dhe mos me marr vendime "shkel e shko" e pastaj për ta ndryshuar çdo 6-7 muaj.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, Rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës është një dokument shumë i rëndësishëm dhe si i tillë prek direkt funksionimin e bizneseve si dhe jetën dhe mirëqenien e punëtorëve por edhe të secilit banorë të Komunës së Podujevës. Fillimisht jam e lumtur që propozimin që e kishim bërë edhe më herët që e gjithë rregullorja t'i nënshtrohet procesit të plotësimit ndryshimit është marr parasysh dhe konsideroj që në parim do duhej t'i kontribuonte një procesi më të mirë dhe më gjithëpërfshirës ku secili do të kishte mundësi t'i inkasonte kërkesat e tyre, pra të gjitha bizneset pa dallim dhe jo vetëm disa siç e kishit paraparë më herët dokumentin që e kishin sjell në Kuvend. Në këtë kuptim pra vlen të përhendet edhe fakti që janë përfshirë disa biznese të cilat nuk kanë qenë fare të përfshira në rregullore, po ashtu edhe reduktimi i fetave zyrtare në vetëm 1 janar, 17 shkurt, Dita e Fitër dhe Kurban Bajramit, sepse e konsultova Ligjin për festat zyrtare dhe ua lejonte një gjë të tillë komunave dhe e dimë që ne si Komunë i kemi disa specifika edhe zakone edhe fetare dhe mund të kapërdihet ky si ndryshim, por përtej kësaj në fillim, miratimin e rregullores e cila është aktualisht në fuqi ne e kishim menduar dhe e kishim aprovuar duke u bazuar në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe çfarë kemi bërë sot është që disa punëtorëve e rrjedhimisht edhe disa bizneseve ua kemi mundësuar të punojnë e disa bizneseve e rrjedhimisht disa punëtorëve të mos punojnë dhe kam frikë që kjo mund të shkaktoj një pabarazi dhe një diskriminim edhe brenda bizneseve edhe brenda punëtorëve sepse unë konsideroj që secili punëtor dhe çiftë ai që punon në biznese të mëdha ose ata që punojnë në biznese të vogla i kanë disa të drejta të cilat duhet të mos ndjehen të diskriminuara.

U përmenden peticionet, është e vërtetë nga ajo që u interesova sepse këtë pyetje ia kisha bërë drejtorit të DPZHE në mbledhjen e KPF-së, nëse është në dijeni të peticioneve të tilla dhe përgjigja e tij ishte, *unë jam drejtor*, unë u interesova sërish për këtë çështje dhe me sa duket disa peticione të paktën ato që unë fola ishin edhe në kohën para se ju të vini drejtor i DPZHE, por përtej kësaj ne të dy si politolog që jemi e dimë që duhet të sigurohet vazhdimësia e shtetit pavarësisht ndryshimit

të pushtetit politik dhe e dimë se kur duam ta përmirësojmë një gjendje është mirë që të interesohemi për faktet dhe materialet që janë prodhuar që nga momenti i miratimit të rregullores paraprake dhe në fund të sigurohet vazhdimësia sepse disa biznese që e kanë dorëzuar në mënyrë zyrtare të protokolluar një peticion do duhej të merrej pa marr parasysh dhe sidomos kur e ri aktualizojmë këtë çështje do duhej të interesoheshim për këto. Më kujtohet shumë mirë kur e patëm miratuar rregulloren aktuale e patëm parë si lëshim të vogël punën e floktarëve dhe ajo që më duhet shumë e çuditëse, çka mu dukët në fakt ishte se në debatin publik që kishit organizuar ju, kishin qenë prezent dy përfaqësues të floktarëve që ata kishin pasur kërkesa shumë të çarta që atyre t'ju lejohet të punojnë ditën e diele, njëra kërkesë pastaj kishte qenë që të shtunave të punonin deri në orën 22:30, dhe çka mu dukët e çuditshme pastaj ishte që nuk kishit marr parasysh këto kërkesa kur dihet se ashtu sikurse sallonet e ondulimit për femra, po ashtu edhe floktarët dita e diele shihet të jetë më e favorshme për të punuar, madje në disa diskutime që unë kam pasur me ata thonë që cilado gjatë ditëve të tjera do të ishte më e pranueshme të ishte pushim, përjashtimisht ditën e diele. Një gjë tjetër që desha ta potencoj është neni 18 ku thuhet bizneset mund ta zgjasin orarin e punës për rastet e festave zyrtare të parapara me ligjin për festa zyrtare deri në orën 1 të mëngjesit, pyetja është, mos po bie ky nen në konflikt me nenin 4 pikën 1.3 të kësaj rregullore ku janë të shkurtuara, po flas në kuptim të rregullores në tersi ku ju kishit propozuar që të respektoheshin festat zyrtare, kurse me nenin 18 po detyrohen të gjitha festat zyrtare që parashihen me Ligjin për festa zyrtare, apo propozimin të cilin ju e kishit bërë.

Përtej kësaj një çështje të cilën të gjithë kolegët e mi e dinë që unë edhe kur ka qenë LDK-ja në pushtet i kam potencuar sepse edhe i kam pikë të dobët, fjala është për gabimet drejtshkrimore, mund të ndodh që ndoshta pa dashje kishin dalë disa gabime bazike drejtshkrimore prandaj ju lus miqësisht që t'i keni parasysh, kjo për shkak të seriozitetit të vetë institucionit.

Për fund e gjitha kjo çka unë thashë unë e kam vetëm një problem apo hall si problem të vetëm, mos po i hyjmë dikujt në hak me këtë rregullore.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, e di që është një rregullore shumë e ndjeshme, mirë e tha edhe kolegu z.Rafet Llapashtica se ne mund ta lëmë përgjegjësinë dhe të abstenojmë kur i'u referua subjektit të tij PDK, por nuk mendoj se ka të bëjë me 52% sepse edhe për rregulloren aktuale ne mbajmë përgjegjësi përkundër asaj që sa ka qenë drejtori LDK-së z.Mirsad Kamerolli ne të gjithë e kemi votuar unanimisht duke menduar që po i ndihmojmë punëtorët, është sjellë sërish një kërkesë për një ndryshim për zonat rurale dhe që nuk kemi mundur ta trajtojmë.

Ka ardhur një ndryshim tjetër tani, dhe po të ishim ne ashtu siç e tha kolegu z.Rafet Llapashtica që ne i kemi votat 52% atëherë për të gjitha po e lëmë në përgjegjësi të bëjnë pushteti atje, mirëpo Kuvendi i merr këto vendime dhe ne si asamblesitë e marrim përgjegjësi për këtë rregullore.

E di që është temë shumë e ndjeshme dhe të gjithë këtu jemi në atë pozitë që nuk dimë kënd ta mbrojmë, punëtorin apo biznesin, është goxha temë e ndjeshme, madje po i shoh që edhe Grupet e këshilltarëve nuk po deklarohen se a janë për apo kundër, me hap apo me lënë mbyllur punën e bizneseve të dielave, prandaj edhe do të doja që të deklarohet secili Grup se a është për hapje apo për mbyllje, secili vendim që sjellët, këtu jemi dhe mund të votojmë, nëse nuk ju pëlqen rregullorja që e ka sjellë drejtori i DPZHE, ne ta votojmë për ose kundër, kaq.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, këtu po diskutohet për mbyllje dhe hapje totale unike të unifikuar, duhet të bisedohet për mbyllje të dikujt e hapje të dikujt, ju a e keni lexuar rregulloren këtu po thotë nëse kishtimisht z.Doruntina Hasani e ka marketin apo një lokal 50 m² punon tjetri market nuk punon sepse është 50.5 m², tani ky mendim të hyjë si pasus është vetëm konkret i drejtorit të DPZHE-së, i Ekzekutivit dhe i LVV-së, ky mendim nuk është i shkruar askund në ligj, nëse mundet ndonjë akter, prej z.Shpejtim Bulliqi e tek ti drejtor, të na tregoj një pasus juridik të Ligjit

të punës, ligjit për biznese apo edhe çka ka legjislacion në RKS dhe që është në harmoni me të drejtën ndërkombëtare, se është mirë dhe bënë kështu që qysh thoni ju, besoj që i pari jam që do ta votoj. Pastaj parafolësja e tha se nuk është përgjegjësi ekskluzivisht e Ekzekutivit, por unë e them se përgjegjësi është menaxhimi i gjendjes, udhëheqja, ndryshimi, rregulloret, plotësim ndryshimi i rregullores etj etj. E them këtë sepse ne më herët e mbështetëm propozimin e drejtoreshës së DPKGJ-së edhe nëse nuk është e Vetëvendosjes, nuk e di sepse atje me LVV dhe me Kryetarin z.Shpejtim Bulliqi po qëndron, e ka nënshkruar vendimin dhe ne e ngritëm dorën për kthimin e pronave komunale prej pronave të ish kooperativave bujqësore, pastaj edhe ky drejtor i DPZHE është i Ekzekutivit por që nuk ka qëndrim as të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, prandaj unë po kërkoj që të del në foltore shefi i Grupit i LVV-së, ta thotë që LVV-ja është që në këtë formë të funksionojnë bizneset ne Podujevë, mirëpo ju nuk po keni dëshirë të thoni ashtu, por po keni dëshirë në ambient të mbyllur t'i bëni këto ndryshime dhe t'jua votojnë partitë tjera dhe pastaj të thoni Kuvendi e ka miratuar.

Unë në emër të PDK-së po deklarohej dhe po e them se jemi kundër diferencimit ekonomik, dhe po e them shumë qartë. Pastaj po e them se nuk ka ligj në bazë të të cilit mund të ndahet kështu në këtë formë rregullorja në fjalë, nëse mendon një drejtor, kushdo qoftë dhe i cilësdo parti qoftë, me sjell rregullore siç mendon ai, dhe ne ta ngritim dorën, gabim e ka sepse nuk ka për të marr votën asnjëherë. Mandej në opinion publik, para kësaj kamere që qenka këtu TV Llapi apo kushdo që mund të jetë, nëse mund të deklarohej ndonjë akter i LVV-së dhe të thotë, shembull, të nderuar qytetar qëndrimi i jonë si Ekzekutiv është që bizneset deri në 50 m² të lejohet të punojnë e ato me mbi 50 m² nuk mundën, të dal ta thotë këtë, dhe vota jonë shkon për, mos të bëhet popullizëm këtu por të ketë qëndrime politike për qytetarët sepse jemi përfaqësues të tyre pavarësisht që jemi edhe pak muaj e që pastaj nuk dihet fare kush jemi në këtë sall fare, kurse unë po ju tregoj që këto model rregullore të z.Agim Bahtirit “çobanëve të lopëve”, edhe nga partisë ime po të ishin, ato do ta quaja budallallëk sjelljen në Kuvend dhe bërjen temë, ne po duam të tregohemi kush po jemi më popullist. Unë e kam një kërkesë tani, meqë 13 kërkesa të bizneseve i ka drejtori i DPZHE, unë i kam 105 kërkesa në letër, ndërsa drejtori nuk po tregon me cilin biznes ka kontaktuar, pra t'i lexon ato kërkesa. Sa për mua 34 këshilltarë votojeni këtë propozim rregullore, unë jam kundër dhe absolutisht nuk kemi asnjë përgjegjësi për Podujevën sepse jemi në opozitë, kurse ju si pozitë dhe qeverisje po doni me i kalu vendimet dhe me bartë përgjegjësinë kolektive me opozitën, nuk ka ashtu. Ne duam ta dimë qëndrimin e programit të z.Shpejtim Bulliqit me Ekzekutivin e tij, cili është menaxhimi i tij në këtë kohë, vetë Kryetari është kundër kësaj rregulloreje që e ka sjell drejtori i DPZHE, sepse ka thënë është mirë t'i zbllokojmë bizneset sepse po duhet të shkojmë në ne fshatin Lupçë për të blerë diçka të dielave, andaj po ta dija çka dëshiron z.Shpejtim Bulliqi, unë përgjigjen time e kam. Prandaj mund ta hedhni në votim e pastaj secili e jep qëndrimin e vet se si voton por ju tregoj se votën time e ke kundër, unë nuk kam asgjë kundër por nuk jam për t'i bllokuar bizneset, mirëpo kështu nuk bënë.

z.Agron Hyseni, theksoi, unë i kam disa pyetje për drejtorin e DPZHE-së, në cilat kritere jeni bazuar dhe në çfarë baze ligjore që i ke caktuar 50 m² me sipërfaqe për bizneset që të punojnë dhe a ke menduar dhe a e dinë se sa është numri i bizneseve me këto kritere që ju i keni përcaktuar, pra ato nuk punojnë ditën e diel. Pastaj ka pasur kërkesa të vazhdueshme në rrugën Lluzhan Orllan për të punuar ditën e diel, si keni menduar me zgjedh problemin e këtyre bizneseve pasi që kanë pasur edhe kërkesa të vazhdueshme. Çështja tjetër, për bizneset individuale të cilët nuk e kanë të deklaruar punëtorët si do të rregullohet çështja e tyre e punës ditëve kur kanë dëshirë të punojnë, do të thotë u garantohet kurse ata nuk kanë punëtorë dhe dëshirojnë që dita e diel të jetë ditë pune,

si do të veproni me këto raste. Mandej për floktarët si do të e rregulloni çështjen e tyre pasi që edhe ata kanë pasur kërkesa të vazhdueshme për të punuar ditën e diel dhe me orar të zgjatur.

z.Adnan Zymeri, theksoi, në nenin 18 paragrafi 3.1 të kësaj propozim rregulloreje thotë që bizneset që dëshirojnë të punojnë më gjatë duhet të bëjnë kërkesë tek drejtoria për t'iu lejuar apo jo, dua të di i nderuar drejtor i DPZHE, në bazë të cilave kritere pranohet apo refuzohet kjo kërkesë, dhe ku jeni bazuar që keni vendosur vlerë nominale monetare 50€ për një orë pune shtesë.

z.Florent Hasani, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Grupi i LVV-së sugjerimin e tij do ta jap më vonë. Besoj që debati është shterur dhe përveç përgjigjes së drejtorit të DPZHE që do t'ju jap kolegëve, të hedhet në votim.

z.Agim Behluli, theksoi, vetëm desha ta pyes direkt drejtorin e DPZHE, ku e ka parë këtë rregullore, në cilin shtet ekziston sepse kesi lloj rregulloreje me 50 m², na paske nxjerr telashe tani me dalë dhe me i matë lokalet, kush e bënë këtë punë, janë 400 deri 500 lokale në Komunën e Podujevës të cilat duhet me i matë dikush cilat janë dhe cilat jo 50 m². Në çiftë se është thënë lokali që i ka 50 m² punon kurse me 51 m² nuk punon, atëherë duhet të dalësh t'i drejtor të matësh. Ju lus që ekonominë mos me prek, ekonomia ka nevojë për infuzione por jo injeksione, edhe pse 20 vite nuk kemi lënë gjë pa i bërë, në gjitha mënyrat i kemi shkatërruar dhe tani edhe në këtë formë me u sjell mua personalisht nuk më pëlqen kjo formë e cila e diskriminon ekonominë sepse dikush të punoj e dikush jo nuk bënë, është dashur ta lëni një liberalizim sepse nuk është më koha e viteve 88-89 kur ka qenë kohë komunizmi, tani është demokraci dhe duhet të punojnë të gjithë, madje do të ishte mirë të gjendet mundësia e rritjes së orarit të punës, e jo me zvogëlohet ngase ekonomikisht qëndrojmë keq dhe përveç asaj ne e kemi pasur një rrugë dhe situatë pothuajse të gjatë nga covid-19 që e ka dëmtuar goxha shumë ekonominë, kurse tani të nxirren këto telashe, për mua personalisht është e pa pranueshme.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, po mendoj se po zgjatet debati paksa, nëse kanë propozime të dy Grupet e këshilltarëve (LDK dhe PDK), mund t'i paraqesin dhe të hidhet në votim. Kështu vetëm po debatohet pa pasur ndonjë propozim, me gjasë jemi për t'i liruar krejt bizneset, kështu që të kuptohet prej secilit, të jepen propozimet prej tyre dhe të votohet, por jo të zgjatet më shumë debati rreth kësaj çështje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, znj.Doruntina Hasani më falni, por debatet duhet të shteren maksimalisht, secili këshilltar e ka fjalën e tij dhe për këtë që ditën e parë ju kam thënë që këtu në Kuvend është vendi për debate e jo qosheve dhe skajeve, prandaj këtë premtim do ta mbaj deri në fund.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi, faleminderit të gjithëve edhe për kritikën vërejtjet disa prej tyre me vend, edhe për këshillat e dhëna, por kur jemi te këshillat me që kjo pikë ka kaluar në debat publik vetëm me votat e opozitës kam pritur që në periudhën e debatit me qenë shumë aktiv, ka qenë e natyrshme që ju me ardh por keni munguar ne debat publik dhe keni munguar edhe në dhënien e propozimeve, nuk keni kërkuar asnjëherë asnjë takim sepse ju keni insistuar me kry ose me tërheq këtë propozim rregullore, por sido që të jetë po përpiqem pa iu marr shumë kohë t'ju jap përgjigje. Sa i përket asaj që u tha se unë jam kundër ekonomisë së lirë të tregut, nuk qëndron ajo sepse nuk jam kundër ashtu siç nuk jam edhe për njëfarë anarkie, mirëpo kur bizneset i përcaktojnë rregullat vet edhe luajnë me punëtorët dhe të varfëritë qysh ata dëshirojnë vet besoj që parimisht as z.Hasan Ajeti nuk është për këtë çështje, mirëpo këtë po e them vetëm sa për qartësim.

Sa i përket peticioneve dhe kërkesave, unë personalisht e kam pasur obligim me mbajt debatin, më vije keq që më kanë ardhur mua pak kërkesa, kurse më shumë kërkesa juve, por sigurisht që po të më vinin me kohe i kisha shqyrtuar më seriozisht, madje kam bërë përpjekje ta takoj edhe shefin e Grupit të këshilltarëve të PDK-së, mirëpo nuk kemi mundur të takohemi në mënyrë që t'i

harmonizojmë qëndrimet, kurse për Grupin e LDK-së kam pritur propozime dhe harmonizime sepse ka qenë e natyrshme meqë me propozim të tyre është shtyrë, e që konsideroj se ka qenë detyrë e tyre sepse kanë qenë sponzorizuesit e dytë, pas meje, të vënies në debat publik të kësaj rregulloreje. Pra ky është problem i trashëguar dhe problem të cilin e keni votuar të gjithë ju, mund ta hidhni fajin kudo, por fjalën e fundit e thotë Kuvendi, pra është problem që e kam trashëguar prej jush si Kuvend, dhe unë kam bërë përpjekje për ta bërë një zgjidhje.

Sa i përket pyetjes rreth kritereve dhe përfundimeve tonat si Drejtori, mund t'ju them se asnjë nuk e kam shpikur unë por të gjitha kanë qenë propozime që mua më kanë ardhur prej bizneseve dhe individëve të bizneseve. Lidhur me floktarët, unë para debatit publik kam mbajtur një takim me 90% të tyre, unanimisht të gjithë kanë kërkuar që dita e diele të mbetet ditë pushimi për ta, prandaj unë nuk mund ta ndryshoj rregulloren dhe nuk mundem të propozoj pse një biznes në një zone të caktuar kërkon të bëjë diçka të tillë, kur shumica e atyre bizneseve janë kundër.

Lidhur me nenin 18 të propozim rregullores, jua rikujtoj se në debat publik e keni hedh rregulloren në tërësi dhe ne ndryshimet i kemi bërë në ato pika ku kemi pasur propozime, neni 18 është nen që e keni votuar në rregulloren aktuale që është në fuqi, pra e gjeni tarifën dhe kushtet që janë përcaktuar këto tarifa dhe për këtë mund ta pyesni ish drejtorin e DPZHE por edhe veten sepse e keni votuar vet pa e shqyrtuar mirë në atë kohë.

Ishte një vërejtjeje shumë me vend për gabimet drejtshkrimore, besoj që kjo është përgjegjësi e Drejtorisë dhe unë e marrë këtë përgjegjësi që nuk e kam marr seriozisht t'i bëjë korrigjimet, kështu që faleminderit për këshillën dhe në rastet e tjera do të përpiqem të jem më i kujdesshëm. Kriteret për lokalet deri 50 m² kanë qenë kërkesat kryesore të bizneseve që nuk e tejkalojnë këtë sipërfaqe, nuk është propozimi që vetëm bizneset që kanë 50 m² po deri në 50 m², shumë prej bizneseve nuk e arrijnë 50 m², shumica e bizneseve në fshatra mezi e arrijnë 20 m², pra ky kriter ka qenë në masë të madhe për t'iu mundësuar punën bizneseve të fshatrave sepse në fshatra nuk kanë furra siç kemi ne në qytet dhe që mund të furnizohemi me bukë, atyre iu duhet të dalin në qytet për tu furnizuar, pra dyqanet ushqimore janë mënyra e vetme që ata të furnizohen, shumica e shitoreve janë më të vogla. Pastaj me këtë nen, edhe pjesës së liqenit të Orllanit iu mundësohet të hapin dyqanet ditën e diele, besoj që e kemi menduar mirë me këtë nen, pra hapen rreth 99 % e bizneseve që funksionojnë në zonë e liqenit. Sa i përket asaj se ku e kemi marrë këtë model, mund t'ju them se kam konsultuar edhe misionet e huaja që janë në Kosovë të cilët na vizitojnë më shpesh dhe bisedojmë për temat dhe problemet e Komunës, kam konsultuar edhe përfaqësuesit e KFOR-it Suedez, kamë parë edhe modelin në Gjermani ku ditën e diel kanë punuar vetëm ato që në gjermanishte iu thoshin "Kiosk" e që nuk e kalonin 50 m², ato punonin ditën e diele kurse qendrat e mëdha tregtare pushonin, ky është modeli që e kam marr nga Gjermania, kam konsultuar edhe njerëz të tjerë por edhe kanë qenë kërkesa. Pra e imja është me dhënë propozimin, demokracia e përcakton që ju me vendos, kështu që ju votoni çka mendoni që është e arsyeshme.

z.Florent Hasani, theksoi, kisha sugjeruar që të mblidhen shefat e Grupeve të këshilltarëve për diskutim dhe në fund të japet një propozim konkret, natyrisht nëse janë të pajtimt edhe kolegët.

z.Hasan Ajeti, theksoi, fillimisht ju rikujtoj se këtë propozim ndryshim të kësaj rregulloreje i nderuar Kryesues e sjellë vet drejtori z.Pajtim Balaj dhe mos të tentoi ky që tani këtu të thotë se unë e përgatis por ju si Kuvend jeni ata që vendosni, nëse ju referohesh të gjithë LDK-së atëherë e ke totalisht gabim sepse në mesin e atyre akteve janë edhe aktet ku janë bërë edhe për shumë Drejtori tjera, në çoftë se i referohesh drejtorit të DPZHE qe ka qene para teje, në çoftë se edhe ai e ka bërë keq atëherë ju rregullojeni, prandaj nuk është argument ai që të nxirret tani duke thënë se ka thënë X personi, tani unë po e ndryshoj, kjo është kompetencë e jotja lëndore drejtor, mos tento tani me biznese të veproni kështu sepse ju e keni paraparë, unë nuk kam hyrë në tematikën sa i

përket 50-60 m², ti e ke bërë një ndarje të tillë dhe është ndarje e bizneseve që e ke bërë, të vogla, të mesme dhe të mëdha, ndërsa tani cilësimet se si i trajton ti është temë e jotja.

Unë gjykoj se është mirë të hedhet në votim propozimi i kësaj rregulloreje dhe të dalim në pauzë.

z.Bashkim Syla, theksoi, unë mendoj që është shumë mirë me dalë prej kësaj gjendjeje dhe kisha propozuar që me u shty për seancën e ardhshme si pikë e rendit të ditës dhe brenda asaj kohe shëfat e Grupeve me dhënë një qëndrim të përbashkët sepse është në interes edhe të bizneseve edhe interes i qytetarëve që me u rregullu kjo çështje kështu që kisha propozuar me u shty kjo për seancën e ardhshme.

z.Agron Hyseni, theksoi, i nderuari drejtor i DPZHE-së, për pyetjen për bizneset individuale të cilat dëshirojnë të veprojnë ditën e diele nuk mora përgjigje, pastaj për zonën e Orllanit e potencuat që janë 99 % të përfshira me këtë 50 m², unë ju pyes tani, sa biznese janë në rrugën Lluzhan-Orllanë pasi veç e paske nxjerr këtë përqindje e që mu duk përqindje e përgjithshme.

z.Florent Hasani, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, ishte një propozim prej kolegut që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi, ajo që unë potencova 99 % të bizneseve e mendova si përqindje e përgjithshme, isha duke folur për të përgjithshmen por e thashë që në këtë të përgjithshme përfshihen shumica e bizneseve tek liqeni me përjashtime të vogla, nuk kamë dalë për ta parë por mund të ketë përjashtime të vogla. Është edhe neni 20 sipas të cilit me leje të posaçme të DPZHE, kushdo që të jetë drejtor në të ardhmen për të mos u kthyer në atë që z.Hasan Ajeti e tha se është individuale për mu, mundet me vendim të posaçëm kur e kërkon interesi publik, e që interesi publik kërkon që është zona e liqenit prej ku turizmi i Llapjanëve e ka shtyllën e vetme, mund t'i lejoj të punojnë bizneset që janë më të mëdha se ato veprimtaritë e ndryshme, nëse vetëm kërkesa është e arsyeshme për ditën e diele.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, pyet këshilltarin z.Bashkim Syla se a ishte propozim i tij personal apo në emër të grupit të këshilltarëve që i takon.

z.Bahkim Syla, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, po propozimi ishte që të shtyhet për seancën e ardhshme dhe brenda asaj kohe të gjitha Grupet politike mund ta marrin një vendim, t'i harmonizojnë qëndrimet dhe të vijnë deri tek një përfundim sepse është në interes të gjithë qytetarëve dhe bizneseve që të rregullohet kjo çështje.

z.Hasan Ajeti, theksoi, unë e thashë edhe më herët, është sjellë ky propozim nga DPZHE, dhe unë gjykoj se nuk ka çfarë të diskutohet më tepër apo të shtyhet, të hedhet në votim dhe pastaj e shohim a kalon apo nuk kalon. Nuk po besoj që është në kompetencë të shëfave të Grupeve tani ne ta diskutojmë propozim rregulloren sepse ndryshimin e rregullores e ka iniciuar z.Pajtim Balaj i cili me te drejtë e ka parë të arsyeshme mbi atë bazë edhe e ka sjell, tani a bëhet shkelja a ka pakënaqësi apo jo është temë tjetër, mirëpo si procedurë është mirë me vendos në votim dhe pastaj kalojmë në pikat e radhës, në qoftë se na jepet mundësi.

z.Florent Hasani, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështet propozimin e PDK-së që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet dhe kërkojmë që ai propozim të vihet në votim dhe në të ardhmen të mblidhen të gjitha Grupet dhe t'i vendosin propozimet e tyre që i kanë lidhur me orarin e punës e pastaj bashkërisht të arrijmë një marrëveshje dhe ta sjellim pikën në Kuvend.

z.Hasan Ajeti, theksoi, është interesant harmonizimi i këtyre dy subjekteve (LVV, PDK) rreth kësaj pike përderisa aty në foltore u pa një lloj i arsyeshëm i opozitës në kuptimin e hapur, unë atë që e flasë qëndroj pas, dhe sërish unë jam pro asaj, andaj të vendose në votim në procedurë të rregullt siç përcaktohet, të kaloj ky propozim dhe atëherë e merr përgjegjësinë edhe PDK që po e shoh që po e lehtëson projektin që është pjesë e Ekzekutivit.

z.Bashim Syla, theksoi, unë e propozova dhe e thashë se po nisem prej parimit të interesit të qytetarëve sepse ne po i përfaqësojmë qytetarët, unë mendoj që është zgjedhja më e mirë, sepse DPZHE e ka propozuar këtë rregullore për gjithë bizneset të punojnë ditën e diel, mirëpo kemi pasur ankesa prej bizneseve, por reforma siç e potencoj drejtori i DPZHE që i bie të diferencohen bizneset nuk është në rregull, kështu që të shtyhet kjo dhe të gjendet një zgjidhje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë po i hedh në votim dy propozimet, propozimin e z.Bashkim Syla dhe propozimin e pikës së rendit të ditës. Kush është për që të miratohet propozim Rregullorja për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Ndërsa atë e potencuat dhe propozuat tani është dashur ta thoni në fillim të mbledhjes që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, nëse ka papajtueshmëri mund të ankoheni tek organi kompetent.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, këshilltari z.Bashkim Syla e dha një propozim, përse nuk po e hedh në votim atë propozim i nderuar Kryesues, këshilltari i cekur e tha se mundemi me shty për seancën e ardhshme nëse vendoset me u shty, atëherë pse të votojmë për, kundër apo abstenim, nëse nuk shtyhet atëherë votojmë sot dhe vendosim çka të bëhet me këtë rregullore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kush është për, që të miratohet propozim Rregullorja për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 15 vota janë KUNDËR, 3 vota janë të PËRMBAJTURA, asnjë votë PËR, për shkak se pjesa tjetër e këshilltarëve nuk morën pjesë në votim, nuk miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po e shohë se ka kaluar në shaka sepse nuk ka seriozitet të merremi me këto çështje. I nderuar Kryesues i Kuvendit, ishin 3 propozime konkrete për të cilat mendoj se si institucion duhet t'i zbatojmë. Pra kemi propozimin e drejtorit të DPZHE që kjo propozim rregullore të kaloj ashtu siç e ka sjellë, pastaj ishte propozimi i shefit të Grupit të LDK-së që kjo rregullore të hedhet në votim, si dhe ishte propozimi i kolegut z.Bashkim Syla në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës dhe që deri atëherë të takohen shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe të marrin një qëndrim të përbashkët, por nuk ka propozim të Grupit të këshilltarëve të LVV-së që zyrtarisht është në pushtet.

Ne mund të rrimë këtu deri në mbrëmje dhe nuk e kemi atë problem fare, por problemi është që nuk po ka seriozitet për ta shtyrë këtë pikë siç u kërkua, përndryshe ju LVV duhet me dalë së bashku me shefat tjerë të subjekteve në Kuvend dhe të thoni i kërkojmë Kuvendit dhe këshilltarëve të tij që kjo propozim rregullore që e ka sjellë drejtori i DPZHE të shtyhet.

Po të mund të kalonte kjo rregullore ajo do të bëhej qysh më herët e që disponimi ka qenë që të kaloj kështu siç është sjellë si dokument e që po shihet se nuk është në rregull dhe që ose duhet të shtyhet ose të shfuqizohet që pastaj të bëhet një rregullore e mirë e që për mendimin tim nuk do të vendosja fare rregullore por vetëm duhet vendos ligjin në funksion, kush dëshiron le të punoj kush nuk dëshiron të mos punoj, pra është ligji që e rregullon këtë.

Edhe në seancën e kaluar kam thënë që është mirë me dal dhe me u taku me te gjitha bizneset, këto bizneset e mëdha që i ka sanksionuar kjo propozim rregullore nuk e kanë ditur që ne dikë po e hapim e dikë po e mbyllim, dhe për këtë arsye nuk janë lajmëruar fare, këtu është problemi. Institucioni i Komunës duhet të shkojë me veturë zyrtare në të gjitha bizneset dhe të ju tregojnë kështu-ashtu është problemi, në mënyrë vullnetare pastaj besoj që secili vijmë dhe e miratojmë, por nëse dëshironi që ta provoni a po kalon apo jo rregullorja, vëni në votim dy propozimet kaloj

nuk kaloj dhe mirupafshim. Ne PDK e kemi propozimin, kështu kjo rregullore nuk kalon, jo që nuk i ka votat, por edhe nëse i ka votat nuk bënë të kaloj sepse është interes individual e jo kolektiv, madje edhe Grupi i LVV-së është kundër kësaj rregulloreje që e keni sjell ju si drejtor i DPZHE, pra propozimi jonë ishte që të shtyhet kjo pikë për seancën e radhës, për propozime tjera ne abstenojmë, kurse për propozimin me kalu kjo rregullore ne jemi kundër, pra ky është qëndrimi ynë si PDK.

z.Hasan Ajeti, theksoi, mendoj që paksa është tejkaluar debati, është interesante tani kur dëgjohet prej drejtorit të DPZHE i cili natyrisht vije nga LVV që thotë ne e kemi jap një propozim prej drejtorit të DPZHE dhe që vije prej LVV-së dhe pastaj nuk ka të drejtë askush të flet në emër të tyre. Prandaj propozimi është, nëse kalon mirë, nëse jo të mbyllet kjo temë, në rast se u jepet hapësirë tani të debatohet ne do të kalojmë edhe një orë dhe nuk do të gjejmë zgjidhje.

Vetë LVV e ka sjell këtu dhe e ka paraparë ashtu dhe është çështje e tyre, nuk është çështje e opozitës e më së paku e LDK-së.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, debati rreth kësaj pike u mbyll dhe votimi përfundoj pak më parë, pavarësisht se i'u dha fjala dy këshilltarëve parafolës.

Tani shkojmë në pauzë, nga ora 13:15 vazhdon se seanca.

Pauzë, ora 12:05

Pas pauzës, mbledhja vazhdon duke filluar në ora 13:40.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi kuorumin ku aktualisht prezent në sallë ishin 29 këshilltarë/e të Kuvendit.

4. Propozim Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës **- Raporti nga mbajtja e diskutimit publik**

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para dy muajve kemi paraqitur propozim rregullore të re për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, kanë kaluar të gjitha procedurat e parapara sipas ligjit, është mbajtur dëgjimi publik dhe gjatë gjithë kësaj periudhe kohore nuk kemi pasur ndonjë vërejtje, kërkesë apo ankesë, andaj të nderuar këshilltar/e të Kuvendit nga ana juaj kërkoj që ta mbështetni këtë propozim rregullore.

znj.Arlinda Kadriu, theksoi, të flasësh për fëmijët për rritjen dhe edukimin e tyre është përgjegjësi e madhe e lëre më të punosh në këtë drejtim. Formimi i personalitetit është një çështje e ndjeshme dhe e ndërlikuar që varet nga shumë faktor që në një formë kanë rol esencial për formimin e individit. Prindërit, anëtarët e familjes, mësuesit, bashkëmoshatarët ndikojnë në formimin e personalitetit. Formimi i personalitetit fillon në fëmijërinë e hershme dhe për një formim të drejtë duhet të ketë shumë kujdes për çdo veprim që bëjmë. Gjatë këtij formimi dhuna dhe mënyra jo e drejtë e rritjes dhe edukimit të fëmijëve të abuzuar në forma të ndryshme ndikon në formimin e personalitetit të tyre dhe len pasoja për gjithë jetën si për individin ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Një fëmijë i rritur mirë është një vlerë e lartë për shoqërinë dhe një e ardhme e sigurtë për individin dhe vendin. Më vjen mirë që kjo rregullore që ka ardhë në Kuvend për miratim sepse në shikim të parë kjo rregullore duket shumë mirë andaj pres që kjo rregullore do ta rregullojë këtë çështje jo vetëm në letër sa për të thënë se e kemi një rregullore, por shpresoj se do të kujdeseni që kjo rregullore të zbatohet në përpikëri. Ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështesim këtë propozim Rregullore sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

znj. Adelina Stublla, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështesim dhe përkrahim këtë propozim rregullorë.

z. Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahim këtë propozim rregullorë. Mirëpo sa i përket propozimit që bëra më herët e që nuk u hedh në votim, mendoj se është bërë shkelje e rregullores së punës së Kuvendit, konkretisht neni 43 paragrafi 1, shkronja c, ku parashihet se propozimet për çështjet konkrete kompletohen me të dhëna shtesë dhe çështja shtyhet për shqyrtim në Kuvend për mbledhjen e radhës. Mendoj se kjo procedurë është shkelur andaj ne do të ankohe mi lidhur me çështjen konkrete.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket vërejtjes për shkeljen e Rregullores së punës së Kuvendit, është ministria përkatëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë për këtë çështje, andaj unë pres çdo vendim nëse eventualisht ka shkelje të rendit të ditës për arsye se pikat e rendit të ditës i kanë plotësuar të gjitha kriteret dhe nuk ka pas nevojë për plotësim ndryshim sepse ka ardhë si pikë e dakorduar përmes propozimit dhe është votuar.

Nëse ndokush dëshiron fjalën apo ka ndonjë propozim, rekomandim apo vërejtje rreth propozimit në fjalë sipas kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se me 28 vota PËR, asnjë KUNDËR, dhe asnjë votë të PËRMBAJTUR, miratohet Propozim Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhjeje.

5. Propozimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. prot. 01-352/04-0023112/20 të datës 22 maj 2020 e ndërlidhur me Rregulloren bazë nr. prot. 01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës.

z. Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për shkak të udhëtimit zyrtar në shtetin e Turqisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, kohë më parë kjo rregullore që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave është aprovuar në Kuvend, mirëpo për disa arsye është shtyrë zbatimin e kësaj rregulloreje. Arsyeja pse tani është propozuar për shtyrje sërish zbatimi i kësaj rregulloreje është përgatitja e një softueri për menaxhimin financiar për të hyrat vetanake, si dhe mungesa e stafit të trajnuar për këtë çështje kur dihet se ende nuk kanë filluar zhvillimi i procedurave për rekrutimin e stafit civil.

Vlen të ceket një praktikë e Komunave tjera të cilat kanë filluar faturimin e mbeturinave në bazë të regjistrimit të njehsorëve elektrik dhe kanë hasur në probleme me bashkatdhetarët tanë që jetojnë në diasporë, ku iu janë faturuar mbeturinat gjatë tërë vitit dhe nga ana e tyre janë parashtruar ankesa, kur dihet se bashkatdhetarët tanë qëndrojnë për pushime në Kosovë një ose dy muaj, është mirë që ne t'i shmangemi atyre problemeve dhe të bëjmë verifikimin e terrenit për shtëpitë që ka banorë rezidencial gjatë tërë vitit, andaj kjo është arsyeja e shtyrjes së zbatimit të kësaj rregulloreje e cila është propozuar të fillojë të zbatohet nga data 01.07.2022.

znj. Valbona Kadriu-Podvorica, theksoi, sa i përket propozimit për plotësim ndryshimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, e mbështesim këtë.

znj. Doruntina Hasani, theksoi, pas sqarimit që bëri drejtori lidhur me rregulloren në fjalë ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së, e mbështesim këtë propozim, kurse sa i përket disa problemeve rreth zbatimit të kësaj rregulloreje në Komunat tjera, shpresojmë se në Komunën e Podujevës të mos kemi probleme të tilla dhe në vitin e ardhshëm të fillojë zbatimi i kësaj rregulloreje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, për shkak të udhëtimit zyrtar në shtetin e Turqisë të drejtorit të Drejtorisë përkatëse, në mungesë të tij, drejtor i DBF, sot para nesh na e transmetoj qëndrimin e tij lidhur me propozim rregulloren në fjalë. Këshilltarët e dy subjekteve politike LDK dhe LVV e mbështeten këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo arsyeje pse është shtyrë zbatimi i kësaj rregulloreje është se drejtori i DSHPMSh nuk e ka kryer punën e tij. Rekrutimi i stafit civil sipas procedurave ligjore mund të zgjatë më së shumti 30 ditë për një konkurs. Komuna e Podujevës prej rreth 100000 banorëve që ka së paku janë 1000 ekspertë - programer të IT-së, pastaj janë 10 ose 15 biznese që ofrojnë programe të ndryshme për shumë kompani dhe biznese, madje edhe për ato jashtë vendit si në SHBA dhe Kanda. Drejtori i DSHPMSh është deklaruar se nuk ka mjete për blerjen e softuerit, kurse unë jam shumë i sigurt se drejtori nuk ka pyetur fare se sa kushton një softuer, por megjithatë lidhur me mjetet financiare mund të na njoftoj drejtori i DBF-së.

Sa i përket procedurës së prokurimit dhe zyrtarit të zyrës së prokurimit ku nga ana e LVV-së është quajtur kriminel dhe ndërmjetësues dhe i është bërë kallëzim penal, andaj ju mund t'i drejtoheni zyrtarit në fjalë dhe shumë shpejt ai do ua bëjë zgjidhjen, por tani kërkoni të shtyhet zbatimi i kësaj rregulloreje deri në vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit, i kërkoj parafolësin që ta tërheq fjalën kriminel që e potencoj, sepse nuk përkon me debatin dhe rregullat e punës së Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, zotëri Kryesues i Kuvendit, me këtë emërtim e kanë cilësuar subjekti i LVV-së dhe është shumë e vërtetë se e kanë quajtur edhe "sekser të bizneseve".

Kryesues i Kuvendit, sërish i drejtohet këshilltarit parafolës, i nderuari këshilltar, nga ana e juaj kërkoj që të jeni i përmbajtur rreth deklaramëve që po i bëni.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, zotëri Kryesues i Kuvendit, kjo sallë ju takon kuvendarëve dhe unë e paraqita një realitet që ka qenë. Një Drejtori nuk mund të arsyetohet se nuk ka pas mundësi t'i kryej punët dhe detyrat e saj për shkak të mungesës së rekrutimit të stafit civil, andaj kjo nuk është arsyeshmëri. Ne mund të kemi disponim dhe të votojmë shtyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje, mirëpo kush do ta merr përgjegjësinë për menaxhimin e mbeturinave kur dihet se Kuvendi ka miratuar rregullore për menaxhimin e mbeturinave dhe Komuna përcaktuar taksë dhe ka kontraktuar Kompani për mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave.

Komuna e Podujevës ka miratuar rregullore për mbeturinat inerte dhe është caktuar lokacioni, mirëpo tani po e shohim gjendjen e pastërtisë në qytet, këtu është problemi sepse ne e mbështesim këtë propozim, madje edhe pa mbështetjen e Grupit të këshilltarëve të PDK-së ky propozim kalon. Llogari nëse kërkojmë prej të tjerëve duhet të kthehemi mbrapa dhe të shikohemi në pasqyrë se kush punon e kush s'punon, drejtori DSHPMSh i cili gjendet për vizitë në Turqi nuk mund të arsyetohet para të gjitha kuadrove këtu se nuk ka mjete financiare për blerjen e softuerit, e që s'e din se sa kushton ai softueri, si dhe mungesa e stafit të trajnuar për këtë çështje për shkak të procedurave të rekrutimit të stafit civil, dhe për më shumë t'i nënçmojmë 100000 llojbanë sikurse të jetë diçka jashtë galaktikë për atë çështje, për ta shkruar emrin e një ekonomie familjare, shembull Fatmir Gashi e ka një pagesë prej 5 €, në softuer sepse aty nuk do të bëhet projekti për "Nasa".

Ne e dimë se çka është softueri ashtu siç e ka bërë Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe pagesat bëhen për çdo 3 muaj, në qoftë se Kompania e kontraktuar nuk e kryen shërbimin e saj atëherë Komuna nuk e bënë ekzekutimin e pagesës. Qytetarët e Komunës së Podujevës shërbimet e tyre i kryejnë në zyrën e kompanisë "Pastrimi" njësoi sikurse ia ka mundësuar kjo Komunë me rreth 100000 banorë KEDS-it që vetëm një zyrë ta ketë ku bëhen pagesat dhe që bëhen qytetarët rresht për një duke pritur në radhë sepse nuk kanë zyrë tjetër.

Arsyeshmërinë të cilën e ceku drejtori i DBF për shtyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje nuk qëndron, edhe pse Grupet e këshilltareve të LVV-së dhe të LDK-së, e mbështeten propozimin për

shtyrjen e zbatimit të rregullores në fjalë deri në vitin 2022. Puna që bëhet në këtë Kuvend është si një lloj shakaje sepse drejtori ka qenë në dijeni se rregullorja në fjalë fillon së zbatuari më datë 02.06.2021, në muajin dhjetor është emëruar drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, që nga ajo kohë kanë kaluar rreth 8 muaj dhe nuk janë zhvilluar procedurat dhe nuk janë kërkuar mjetet për blerjen e Softuerit dhe nuk ka parashtruar kërkesë zyrtare në DBF për blerjen e softuerit, prandaj e them se këtu kemi të bëjmë me një lloj shakaje.

Më çudisin 34 asamblistët se si heshtin kurse bën shaka një njeri analfabet që e ngritë dorën dhe deklarohet se s'ka mjete financiare, ai s'dinë ta shkruaj një letër, s'ka bërë as kërkesë. 20% e buxhetit të Komunës është shfrytëzuar në 6 mujorin e parë prej investimeve kapitale deri në shërbime komunale. Vitin e kaluar rreth 2,500,000.00€ ka qenë suficit buxhetor, këtë vit nëse në rialokim nuk bëjnë shaka 3,000,000.00€ do të mbesin suficit, andaj kush e arsyeton këtë çështje sepse ne nuk jemi kompetent. Nuk e gjykoj drejtorin e DBF-së pse drejtori i DSHPMSh nuk iu ka drejtuar me kërkesë (për blerjen e softuerit), e gjykoj drejtorin e DSHPMSh, kështu që ne jemi kundër kësaj pike të rendit të ditës sepse kemi arsyeshmëri, edhe propozim Rregullorja në fjalë mund të kalojë, mirëpo kjo është një lloj shakaje duke filluar nga Nënkryetaria e Komunës që është prezent këtu e deri te procesmbajtësit atje që janë të vendosur në kabinën elektronike.

Kërkoj falje zotëri Kryesues i Kuvendit, debatin nuk e kam personal me askënd mirëpo se si mendojnë ata (drejtorët) është punë shakaje, sepse ai (drejtori i DSHMS) edhe një herë mund të vije këtu në sallë si drejtor në muajin shtator apo tetor kur janë zgjedhjet, dhe pastaj ec në shtëpi (duke e lidhur me mandat) sepse duhet të ballafaqohet me kritikën secili që e ka atë pozitë të drejtorit të drejtorisë përkatëse.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni kush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës, sipas materialit të propozuar dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se me 24 vota PËR, 2 vota KUNDËR dhe 1 votë të PËRMBAJTUR, miratohet plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores nr.prot.01-352/04-0023112/20 të datës 22 maj 2020 e ndërlidhur me Rregulloren bazë nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës.

6. Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale.

- Propozim vendimi për vënie në diskutim publik

z.Pajtim Balaj, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse, rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, në emër të Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi, e propozoj këtë Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përkatësisht për vënie në diskutim/debat publik. Në seancën e kaluar kemi tentuar ta bëjmë të njëjtën por për shkak se Grupet e këshilltarëve kanë pasur mospajtime lidhur me propozimet që ne i kemi bërë, ato propozime dhe sugjerime i kemi marrë parasysh dhe kemi vendosur në këtë draft që ju është sjellë tani, konkretisht që nenin 6 të rregullores ta ndryshojmë me riformulimin si në vijim, *taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste, subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Podujevës lirohen nga taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste*, pra kjo

është pika më e rëndësishme për të cilën ka pas mospajtime e që besoj se tani këto mospajtime janë sqaruar, andaj kërkoj votën tuaj lidhur me propozim rregulloren në fjalë.

Propozimi është që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data 07 qershor 2021, deri më datë 07 korrik 2021, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më datë 14 qershor 2021 duke filluar nga ora 10:00; në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, meqë herën e kaluar nuk kaloj propozim rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, në pikën të ndryshme në seancën e kaluar unë kam kërkuar që neni 6 i kësaj rregulloreje të fshihet apo të riformulohet, me theks që të gjitha subjektet afariste që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të lirohen nga taksa komunale. Rregullore aktuale është miratuar në vitin 2018, edhe pse në atë kohë është bërë plotësim ndryshimi i rregullores në fjalë dhe rreth 50% e bizneseve janë liruar nga taksa komunale. Kam kërkuar dhe do të kërkoj që të lirohen nga taksa komunale të gjitha subjektet afariste që operojnë në territorin e komunës së Podujevës. Është mirë të bëhet një sqarim, kjo taksë e ka bazën në ligjin mbi financat publike, mirëpo prej të gjitha burimeve të financimit të hyrave vetanake kjo taksë është më problematike për tu inkasuar për faktin se për të gjitha shërbimet aty për aty bëhen pagesat andaj kjo taksë duhet inkasuar me dhunë ose duhet të gjendet një mënyrë e duhur për inkasimin e saj. Nga ky fakt subjektet afariste i kanë mbetur borxh Komunës rreth 3,000,000.00€. Nëse marrim për bazë vitin e kaluar prej 140,000.00€ që janë paraparë nga kjo e hyrë vetëm, 5% janë realizuar, këtë vit në 3 mujin e parë prej 120,000.00€ që kanë qenë të parapara për këtë taksë vetëm 3% janë realizuar, është mirë që në të ardhmen Ekzekutivi të merret me këtë çështje dhe t'i propozojë Kuvendit për faljen e këtyre borxheve, përndryshe mbetet një performancë shumë e keqe e Komunës për mos realizimin e të hyrave vetanake.

Sa i përket propozimit që të vëhet në diskutim publik kjo propozim rregullore, e di që për të gjitha rregulloret është e paraparë që të dalin në diskutim publik, mirëpo ky rast është pak më ndryshe sepse duhet të pyeten bizneset se a dëshirojnë t'u hiqet taksa apo jo, kjo është pyetja e parë dhe është e ditur se asnjë subjekt afarist nuk do të deklarohet kundër heqjes së taksës.

Mendoj se taksa për subjektet afariste në tërësi duhet të hiqet për shkak se dihet gjendja e tyre jo vetëm si shkak i pandemisë por edhe problemeve tjera ekonomike, andaj është mirë që të ndihmohen bizneset sepse ka interes edhe Komuna, hapen vende të reja të punës dhe çështje tjera të kësaj natyre. Kjo taksë e ka bazën ligjore por duhet të mendohet edhe njëherë që të shlyhen të gjitha borxhet e krijuara nga kjo taksë sepse këtë taksë e kanë paguar vetëm ato biznese që kanë aplikuar për tenderë të ndryshëm e që ju janë kërkuar shërbimet për obligimet e tyre kurse subjektet tjetra afariste pothuajse 95% prej tyre nuk e kanë paguar këtë taks dhe kanë mbetur borxhe, andaj jemi që të mbështetet ky propozim për këtë propozim rregullore.

z.Patriot Rudari, theksoi, propozimin që e ka sjellë DPZHE, që të hedhet në diskutim publik propozim rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale është në harmoni me kërkesat e bizneseve dhe të punëtorëve. Ne kemi përgjegjësi para qytetarëve andaj duhet t'i përgjigjemi kërkesave dhe nevojave të tyre.

Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështet këtë propozim rregullore dhe ju bëjmë thirrje edhe subjekteve tjera që ta mbështesin propozim vendimin për rregulloren në fjalë.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së, çdo gjë që vjen për të mirën e qytetarëve e mbështesim, në këtë rast edhe propozim vendimin për vënien në diskutim publik të propozim rregullores në fjalë do ta mbështesim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, meqë nuk të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhje e KPF-së dhe propozimeve të Drejtori të DPZHE rreth kohëzgjatjes së diskutimit dhe debatit publik.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit, konstatoi se NJËZËRI (me 32 vota të këshilltarëve prezent) miratohet Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa tarifa dhe gjoba komunale, përfshirë edhe propozimin që diskutimi publik të zgjatë 30 ditë, përkatësisht nga data 07 qershor 2021, deri më datë 07 korrik 2021, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më datë 14 qershor 2021 duke filluar nga ora 10:00; në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës.

7. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare me destinim për subvencionimin e Klubit të Futbollit Llapi - Podujevë.

znj.Elhame Kutllavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit - DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera theksoi, sportistët janë pasuri e vendit, talenti i tyre shumë herë na ka bërë krenarë si në arenën vendore ashtu edhe në atë ndërkombëtare. këtë herë Komuna e Podujevës u bë temë e diskutimit në gjithë vendin falë përkushtimit të sportistëve. Siç jeni në dijeni Klubi i Futbollit “Llapi” gjatë muajit maj në finalen e Kupës së Kosovës na bëri shumë krenarë si qytetarë të këtij vendi duke na e sjellë Kupën e Kosovës në Podujevë. Si institucion kemi për obligim që përkushtimin, dashurinë dhe vullnetin e të gjithë lojtarëve dhe të gjithë atyre që sakrifikuan që nga fillet e para të themelimit të këtij klubi, Klubin e Futbollit “Llapi” ta shpërblejmë me një shumë simbolike për kontributin e tyre, andaj Kryetari i Komunës, z.Shpejtim Bulliqi ka propozuar që Klubit të Futbollit “Llapi” në Podujevë, t’i ndahet një shumë prej 10,000.00€ për fitoren e Kupës së Kosovës, kjo shumë do të jetë një falënderim për ekipin dhe stafin e Klubit të Futbollit “Llapi”. Ambasadorë më të dinjitetshëm të një vendi gjithmonë janë sportistët, artistët dhe rinia jonë.

z.Qendrim Softolli, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim ndarjen e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit “Llapi”, mirëpo për këtë dihet se këto mjete ndahen nga Kuvendi i Komunës sepse Kryetari i Komunës e ka mundësinë ligjore që të ndajë shumë deri në 5,000.00€. Gjithashtu Jam krenarë që gjatë mandatit të qeverisjes së LDK-së, është rregulluar infrastruktura dhe duke i ndihmuar Klubit të Futbollit “Llapi” që t’i arrijë këto suksese.

z.Bahri Blakçori, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së, e përkrahim këtë propozim, njëherit KF “Llapi” i urojmë suksese edhe në garat ndërkombëtare në krye me z.Tahir Batatina.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së, e mbështetim këtë propozim vendim, mirëpo dua të ndërlidhem me parafolësin se ndoshta do të ishte mirë të deklarohet Kryetari i Komunës se këtë shumë të mjeteve po e ndajmë bashkërisht me ne, dhe mos të deklarohet se këto mjete ndahen në emër të tij. Ne ndihemi krenarë për arritjet dhe sukseset që ka bërë Klubi i Futbollit “Llapi” dhe me kënaqësi e mbështesim këtë propozim vendim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se NJËZËRI (me 33 vota të këshilltarëve prezent dhe me përjashtim të këshilltarit z.Afrim Shabani i cili është pjesë e stafit të KF “Llapi” dhe i cili nuk mori pjesë në votim për shkak të shmangies nga dyshimi për konflikt interesi), miratohet Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare me destinim për subvencionimin e Klubit të Futbollit “Llapi” – Podujevë.

8. Propozim Vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë- 38

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozimi, ndër të tjera theksoi, bëhet fjalë për transferimin e 380,930.00€ nga kategoria rezervë në 4 projekte të cilat Ministria e Financave nuk i ka aprovuar si projekte por i ka kategorizuar si mallra dhe shërbime. Kjo pikë e rendit të ditës ka kaluar edhe në mbledhjen e kaluar nga kjo asamble komunale, mirëpo për disa arsye teknike që i kam sqaruar edhe në mbledhjen e KPF-së, Ministria e Financave e ka kthyer këtë çështje sërish në shqyrtim.

Këto projekte janë projekte të buxhetit për vitin 2021, për disa arsye të caktuara Ministria e financave i ka kthyer në kategorinë rezervë, siç është projekti për rregullimin e hyrjeve banesore që është kategorizuar si subvencion dhe nuk është investim kapital meqë ato janë prona private. Ndërtimin e QKMF-së, arsyen e këtij projekti përse Ministria e ka kategorizuar në kategorinë rezervë është për jetësimin e programit PIP në projektin për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Lagjen e Dëshmorëve, arsye pse është kategorizuar në kategorinë rezervë është një keqkuptim i Ministrisë së Financave e cila ka menduar se këto shtëpi jepen falas, mirëpo këto shtëpi nuk jepen falas se po të ishte ashtu këto do të ishin vendosur në kategorinë e subvencioneve, por meqë nuk jepen falas janë në kategorinë e investimeve kapitale.

Të gjitha projektet janë të njëjtat që janë aprovuar në buxhetin e vitit 2021, përjashtimisht projekti për mbjelljen e drunjtëve dekorativ që Ministria e Financave nuk e ka aprovuar si projekt kapital mirëpo e ka klasifikuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, për projektin e njëjtë furnizim me drunjtë dekorativ, ky projekt është proceduar dhe është në procedura të prokurimit, mirëpo paguhet nga kategoria e mallrave dhe ky projekt është zëvendësuar me projektin për ndërtimin e çerdhes në qytet afër SHLMT “Fan. S Noli”. Në mbledhjen e kaluar të asamblesë komunale është miratuar ky propozim i cili është edhe i aprovuar me buxhetin e vitit 2021, andaj ju ftoj që ta mbështesni këtë propozim pasi janë bërë ri rregullimet ashtu siç rekomanduar Ministria përkatëse.

z.Adnan Zymeri, theksoi, aseti më i çmuar i secilës familje, organizatë biznesi, shoqërie, partie politike, janë njerëzit dhe eksperiencia e tyre profesionale. Qeverisjes së praktikantëve kur ua shton këtu mosbesimin dhe raportet që kanë mes vete në secilën seancë vijnë këso vendimesh me dhjetëra herë. Jam kurioz t’i shohë shpenzimet e letrës së printerit që do të vijnë në raportin e ardhshëm financiar. Në nenin 1 të këtij vendimi specifikohen nën programet dhe vlerat që propozohen të transferohen, nga nën programi bujqësia planifikohen të transferohen 100,000.00€, të cilat nuk janë të specifikuara se në cilin nën program do të transferohen në nenin 2 të këtij vendimi. I nderuari drejtor i DBF-së a keni kontakte me drejtorin e DPUMM, dhe a e keni pyetur se çfarë parasheh me ndërtimin e hapësirave të reja publike në qytet, apo juve nuk ju intereson fare projekti. I nderuari drejtor a keni kontakte me drejtorin e DSHMS-së dhe a e keni pyetur se ku e parasheh ndërtimin e QMF-3, çfarë ka ndodhur që e keni humbur donacioni e qeverisë së Kuvajtit, a keni mundësi ligjore për angazhimin e stafit shtesë për atë objekt dhe a është bërë studim i arsyeshmërisë dhe nëse është bërë ky studim pse po ndodhë që gjysma e Ambulantave të Mjekësisë Familjare të jenë jashtë funksionit me arsyetimin për mungesë stafi.

Nëse drejtori i Drejtorisë përkatëse nuk ju ka pyetur juve drejtor (i drejtohet drejtorit të DBF-së) ju lutem tregoni qytetarëve se çka specifikisht do të realizoni me këto mjete pasi që e konsideroni veten si themeluesit e transparencës në sistemin tonë politik.

E mira e vetme e ri sjelljes së këtij vendimi është se Kryetari gëzohet para kohe për herën e dytë për ndërtimin e çerdhes. I nderuari drejtor i DBF-së, me qëllim që mos të na vije sërish një vendim i tillë për herën e tretë me radhë, miqësisht nëse keni laps kërkoj nga ana juaj që të shkruani këto fjalë që po i lexoj tani. Në bazë të udhëzimit administrativ nr.06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritetizimin e projekteve kapitale, neni 4 paragrafi 8 thotë, çdo projekt i propozuar nga Komuna

për aprovim nga Kuvendi i Komunës duhet të ketë të bashkëngjitur vlerësimin sipas kritereve të këtij Udhëzimi Administrativ.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, pas arsyetimeve të bëra nga drejtori i DBF-së, Grupi i këshilltarëve të LVV-së, e mbështesim transferimin e mjeteve buxhetore për shkak se mendojmë se të gjitha këto projekte kanë një rëndësi të madhe.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, siç duket z.Adnan Zymeri paska shumë mllëf rreth çështjes së transparencës dhe lexoi shumë Udhëzime Administrative, mirëpo ky buxhet është miratuar në kohën e qeverisjes së LDK-së, dhe ju keni qenë anëtar i asamblesë Komunale, të gjitha këto projekte i sqarova më herët, janë që i ka aprovuar kjo asamble Komunale dhe janë pozicione buxhetore, përjashtimisht bënë furnizimi me drunjët dekorativ për arsye se Ministria e Financave në bazë të atij udhëzimi që ju e cekët dhe në bazë të planit për KAB, që vërehet se çka kategorizohet në investim kapital, subvencion, mallë, pagë, atëherë Ministria e Financave e ka konsideruar se ky nuk është investim kapital. Rrjedhimisht ato 100,000.00€ është dashur të alokohen në një projekt tjetër meqenëse furnizimi me drunjë dekorativ ka qenë në planin e prokurimit sepse kategorizimi në kategorinë rezervë ka ardhë në muajin shkurt e faktikisht kur del buxheti për vitin 2021 plani i prokurimit miratohet para muajit shkurt, ne si qeverisje e kemi proceduar dhe është në procedurë të prokurimit dhe është lidhur kontrata për furnizim me drunjë dekorativ. Këto 100,000.00€ është dashur të dalin në një projekt tjetër dhe është menduar se ndërtimi i një çerdheje, projekt i cili është i domosdoshëm sepse është një e vërtetë që nga pas lufta në Komunën e Podujevës nuk është ndërtuar asnjë çerdhe, e që mendoj se ndërtimi i saj është jashtëzakonisht i nevojshëm.

Sinqerisht të paktën kam bërë përpjekje që mos të nxis këtu debate për të kaluarën dhe të tanishmen, apo ka ditur ky e ai jo, mirëpo edhe sistemi PIP që ndoshta për shumë gjëra këtu njerëzit për krejt shpjegimet teknike që mund të bëhen nuk ndjehen mirë. Janë plotësuar nga administrata Komunale e cila ka qenë andaj s'dua të lidhem me atë se kush ka qenë dhe kush i ka bërë gabimet. Fatmirësisht jemi duke bërë përpjekje që drejtorët ta plotësojnë sistemin PIP edhe pse as drejtorët paraprak nuk janë të vetmit që kanë plotësuar këtë sistem, mirëpo unë e kam një përvojë nga vendi i punës së mëparshme që jam marrë me programin e investimeve publike -PIP, në Komunën e Prishtinës dhe këto investime janë pak specifike. Për herë të parë në bazë të Udhëzimit Administrativ të cilin ju e cekët, këtë vit janë shikuar me përpikëri dhe çdo projekt i cili nuk i ka përmbush kriteret e kanë kategorizuar në kategorinë rezervë.

Në mbledhjen e kaluar të asamblesë Komunale kam thënë se Ministria e Financave fatmirësisht i kanë shikuar vetëm disa projekte të reja të cilat nuk kanë pasur kode buxhetore. Sikur të kishin shikuar çdo projekt sigurisht që më shumë projekte do të dilnin në kategorinë rezervë, si do që të jetë nuk dua të ndërlidhem me Ekzekutivin e kaluar, ne jemi duke bërë përpjekjet për trajnimin e një stafi të ri që janë nëpunës aktual edhe pse nuk ka procedura të rekrutimit të stafit civil. Këto janë projekte që janë miratuar në këtë asamble e që janë propozuar nga qeverisja e kaluar. Sinqerisht e them se i kisha kuptuar edhe këshilltarët e LVV-së nëse e kishin kundërshtuar këtë propozim për këto projekte sepse këto projekte janë të miratuara nga qeverisja e LDK-së.

Sa i përket shpenzimeve që i cekët (z.Adnan Zymeri), ai ishte vetëm një sulm i kotë sepse shpenzimet janë minimale, drejtori i DBF-së ujë pinë vetëm kur vjen këtu në mbledhje dhe nuk shtyp asgjë, zero shpenzime. Si Ekzekutiv nuk kemi asnjë shpenzim, sërish e them që nuk dua të lidhem me të kaluarën në asnjë mënyrë por raporti i Auditorit Gjeneral ka ardhë me shkresat që janë bërë në vitin 2020, që vlera e dëmeve është qindra apo mijëra euro, kurse ju po flisni për një letër më shumë, prandaj sinqerisht nuk më pëlqen ky debat që po e zhvillojë me ju, në rregull bëje politikën por mënyra e këtij debati nuk më pëlqen.

z.Adnan Zymeri, theksoi, nuk dëshiroj të bëjë replikë por me qëllim të qartësimit sepse unë nuk kam kurrfarë mllefi me ju zotëri drejtor i DBF, shumë sinjerisht kur diskutohet për problemet të cilat ju i trajtoni nga një fushë e caktuar e në këtë rast me financat e që në të ardhmen mund të bisedojmë për policinë, shëndetësinë, etj, nuk diskutojmë për personin që e udhëheq Drejtorinë përkatëse, por flasim për proceset prandaj mirë është të sqarohemi.

Sa i përket rëndësisë së projekteve të cilat i ke prezantuar se do të transferohen mjetet financiare, Grupi i këshilltarëve të LDK-së ka treguar me votë në seancën e kaluar dhe është miratuar ky propozim. Duket absurde ju si drejtor i DBF me i pranuar gabimet e juaja profesionale para gjithë këtyre personave e që ka shumë prej tyre që në aspektin financiar nuk kanë shumë njohuri, prandaj kritikën merre me sinjeritetin më të madh dhe me qëllimin më të mirë sepse nuk është qëllimi i asnjërit prej asamblistëve për ta kthyer në çështje personale debatin po që se edhe nëse del e kundërta e kësaj ju që e thoni, unë jam në rregull sepse të gjithëdijshtëm nuk jemi. Këtu jemi për të bërë kritika konstruktive dhe nuk kemi nevojë me marrë me negativitet këtë punë.

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, Ambulantat periferike janë mbyllur si shkak i mungesës së personelit mjekësor, prej tyre 12 mjekë kanë shkuar në specializim kurse 40 mjek të tjerë janë të angazhuar në qendrën anti covid. Janë mbyllur disa ambulanta periferike ku frekuentimi i pacientëve është më e vogël dhe është angazhuar personeli mjekësor në disa pjesë ku ka frekuentim më të madh të pacientëve siç është QKMF-ja, pjesa qendrore dhe në fshatrat Lluzhan dhe Kërprimëh. Tani kemi filluar me procedurat për rekrutimin e mjekëve të ri, në konkursin e parë janë rekrutuar 9 mjekë kurse tani kemi filluar edhe me konkursin e dytë që do të rekrutohen edhe 5 mjekë, shpresojmë se shumë shpejt do t'i hapim ambulatat periferike.

z.Agron Hyseni, pyet drejtorin parafolës, sa është numri ambulantave që janë mbyllur.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, theksoi, ambulatat tani më janë të hapura në të gjitha fshatrat, Batllavë, Herticë, Majac, Pollatë kurse në fshatrat Dumnicë dhe Dobratin ende nuk janë hapur ambulatat sepse është duke u bërë inventarizimi. Mbyllja e ambulantave ka ardhë si shkak se në të njëjtën kohë Ministria e Shëndetësisë ju ka dhënë leje për specializim shumë mjekëve, andaj këtë kolaps shëndetësor nuk e ka vetëm Komuna e Podujevës por ka edhe shumë Komuna tjera siç janë Fushë Kosova, Lipjani, Peja e të tjera, mirëpo tani ne jemi në procedurë të rekrutimit të mjekëve të ri dhe besoj se do të bëhet zgjidhje e duhur.

z.Hasan Ajeti, theksoi, pyetje për drejtorin parafolës, në QKMF - Podujevë a është siguruar serum i kundër helmimit nga gjarpërinjtë.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, theksoi, serumin kundër helmimit nga gjarpërinjtë e siguron Ministria e Shëndetësisë, ne kemi kontaktuar me Ministrinë dhe përgjigja e tyre është se janë në fazën e prokurimit.

z.Ragip Fetahu, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, tema për të cilën po debatohet nuk është pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, për mjetet buxhetore duhet të ketë transparencë, për të gjitha transferet në të gjitha projektet.

znj.Adalina Stublla, theksoi, i nderuar Kryesues, hapja apo mbyllja e ambulantave nuk ka të bëjë me buxhet dhe as me obelisk.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolëses, theksoi, funksionimi i QKMF-së është i varur nga buxheti i Komunës dhe nëse nuk ka buxhet atëherë nuk funksionon asgjë.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, theksoi, arsyeja e mbylljes së ambulantave nuk ka qenë buxheti por mungesa e personelit mjekësor.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, z.Ragip Fetahu kur dikush kishte ndonjë pyetje në kohën kur LDK-ja ishte në pushtet njësoj si ju deklaroheshin se këto pyetje janë jashtë rendit të ditës. E rëndësishme është se u hap kjo temë dhe a ka ndonjë ambulantë që është mbyllur në ndonjë fshat. Në këtë periudhë të pandemisë dihet arsyeja e angazhimit të një numri më të madh të personelit mjekësor në zonat urbane që ka një numër të madh të popullsisë, mirëpo duhet kushtuar rëndësi edhe qendrave periferike dhe në zonat më të thella sepse një pacient qoftë i infektuar me virusin Covid-19, për shkak të transportit apo të emergjencës, e ka shumë më të vështirë të arrijë deri te trajtimi mjekësor. Në fshatin ku unë jetoj ka një kohë të gjatë që në ambulantë mungon mjeku specialist, mirëpo shërbimet teknike ofrohen për pacientët. Ambulantat sot a janë të mbyllura apo janë të hapura të gjitha. Për këtë dua të bëjë një sqarim, ambulantat kanë qenë të hapura të gjitha mirëpo janë mbyllur njëherë e pastaj sërish janë rihapur të gjitha. Arsyen e mbylljes së ambulantave e kuptuam të gjithë që ka ardhë si pasojë e mungesës së personelit mjekësor, pyetja ime për drejtorin e DSHMS-së është se a ka ambulanta që ende janë të mbyllura në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, theksoi, të gjitha ambulantat janë të hapura përjashtimisht atyre në fshatrat Majac dhe Herticë që janë duke u zhvilluar punime në objektet. Në disa ambulanta periferike mjekët specialist do t'i kryejnë shërbimet e tyre dy herë në javë kurse sa i përket shërbimeve për rastet e prekura me virusin Covid-19 ne kemi qendrën anti covid që ofron shërbime mjekësore në shtëpitë e pacientëve të prekur nga ky virus.

Sa për informatë, aksidenti në fshatin Llugë ka ndodhur pasi që ekipa e qendrës anti covid i ka ofruar ndihmë mjekësore një pacienti në shtëpi, ndërsa ju (i drejtohet këshilltarit zotëri Rafet Llapashtica) e keni përshkruar si aksident qejfi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ju drejtor i DSHMS e keni kuptuar ashtu mirëpo aksident qejfi nuk ka sepse askush nuk dëshiron të pësoj aksident, andaj jeni shprehur në mënyrë të gabuar sepse keni dashur të thoni diçka tjetër po mendoj. Në kohë pandemie janë mbyllur 12 apo 18 ambulanta, e për punë qejfi personelin mjekësor e dërgon në fshatin Dyz ose në fshatin Herticë, ky nuk është menaxhim i mirë sepse pastaj ndodhin edhe aksidente në trafikun rrugor. Aksident trafiku ka pësuar edhe ish Kryetari i Komunës z.Agim Veliu duke shkuar rrugës për Prishtinë sepse ka udhëtuar 100 km, kurse ka qeverisur Komunën e Podujevës. Unë menaxhoj ndryshe edhe pse nuk jam menaxher i ndonjë institucioni, ideja ime se si me menaxhuar diçka ndryshon shumë sepse nuk është koncept partiak por është koncept individual dhe program i imi personal. Këtu nuk është punë qejfi sepse zyrës së ofiqarisë në fshatin Herticë ju kanë thyer dritaret dhe ka 20 vite që nuk është funksionale andaj këto gjëra nuk amnistohen dhe nuk dua të diskutoj për punët e qejfit sepse pata pyetje direkte.

Shpenzimet që i ceku drejtori bëhen në shuma marramendëse si në telefoni, karburante, pastaj tek ne në Komunë më i lartë ka dal sigurimi i automjeteve se sa numri i automjeteve, prandaj mua personalisht (dushk për gogla nuk mund të më shes askush) e këtë ndonjë asamblisti mund t'ia shesësh. Me profesion jam jurist mirëpo i kalkulojë financat dhe të gjitha shpenzimet qofshin ato të telefonisë, gjykatës, borxhet, shpenzimet e karburantit etj i llogarisë me centë. Këtë llogari nëse nuk mund ta kalkuloni sot ka zyre që kalkulojnë me cent për litër të karburantit për një km rrugë, sido që të jetë unë desha të kyçem në këtë temë pasi që u lidh puna e qejfit. Me qejf ne sot s'do të kishim ardhë në Kuvend, as ju drejtor s'do të kishit ardhë në punë dhe vetëm kishit thënë bëhu sikurse është deklaruar ai që (Albini ka thënë bëhu dhe ai bëhet), mirëpo punët ashtu nuk kryhen. Ne me qejf nuk do të kishim ardhë as në punë, vetëm do i kishim marrë rrogat dhe të gjitha punët do të kryhen pa qenë ne aty. Ky ishte debati që më lidhi me temën e qejfit, nuk kam thënë aksident qejfi sepse aksidentet ndodhin dhe për këtë punë janë autoambulancat. Mjeku nuk guxon të shkojë

me veturën e drejtorit të Drejtorisë së Administratës në fshatin Llugë, sepse janë automjetet e QKMF-së, mjekëve duhet t'ju sigurohen makinat dhe të mbikëqyren që mos të blejnë gjëra në treg, andaj mos më detyroni t'ju sjellë fotografi që personat zyrtar në orare të punës me vetura zyrtare blejnë spinaq në treg, si arsyetoheni këtu duke futur qepë e spinaq në vetura zyrtare.

Në mënyrë miqësore ju lutem që sa më shpejtë të hapen ambulancat dhe të rekrutohet stafi mjekësor sepse ke mbështetjen tonë.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, theksoi, kam një këshillë miqësore për zotëri Lapashticën që mundësisht t'ju kërkosh falje atyre punëtorëve teknik që kanë pësuar aksident trafiku e që i keni përshkruar aksident të personave zyrtar jashtë punës zyrtare dhe që e keni atakuar qeverisjen lokale që nuk ka kontroll për qeverisjen lokale, andaj është mirë t'ju kërkohet falje atyre punëtorëve teknik të cilët kanë qenë në shërbim anti covid, punëtor të cilët nuk kanë qenë në Batllavë për qejfi e as për kafe por kanë shkuar të ofrojnë një shërbim mjekësor në kuadër të qendrës anti covid.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ju drejtor i DSHMS u deklaruar që qendrat e mjekësisë në fshatrat Orllan dhe Kërpimeh janë të mbyllura për ofrim të shërbimit anti covid, tani ju po bini ndesh me arsyeshmërinë që e bëtë, në këtë rast është dashur të mbyllet ambulanta në fshatin Herticë e të hapen ambulancat në fshatin Orllan dhe fshatin Kërpimeh. Në fshatin Orllan po të ishte në funksion AMF-ja, 24h me mjekë dhe infermier nuk do të ishte paraqitur nevoja që ekipet e qendrës anti covid të ofronin ndihmë mjekësore në atë pjesë.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, theksoi, ne kemi ofruar shërbime mobile anti covid pacientëve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sërish po të drejtohem drejtor, të gjithë pacientët e infektuar me virusin covid-19 në fshatin ku unë jetoj është dashur me i sjellë në QKMF- Podujevë.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS, ndër të tjera theksoi, mesatarisht gjatë kohës së pikut të pandemisë i kemi ofruar dy shërbime mobile me dy ekiye mjekësore atë anti covid dhe atë paliativ, prej tyre janë realizuar së paku 75 viza në terren për 24h, është normale se këto dy shërbime nuk kanë pas mundësi ta mbulojnë gjithë rastet andaj është normale se këto vetura kanë lëvizur në çdo cep të territorit të Komunës së Podujevës. Franca, Gjermania dhe shtetet tjera më të zhvilluara në aspektin mjekësor dhe atë ekonomik nuk kanë pas mundësi që t'i mbulojnë të gjitha rastet e paraqitura sepse edhe sistemet më të avancuara shëndetësore pandemia i ka kolaposuar por ne në bazë të mundësive tona kemi vepruar. Sa i përket mbulimit dhe mbylljes së ambulantave periferike është adresa tjetër sepse nuk ka të bëjë me menaxhimin e qeverisjes lokale, e adresa është Ministria e Shëndetësisë së Kosovës e cila ju ka lëshuar licencë për specializim në të njëjtën kohë të gjithë mjekëve dhe i ka kolapsuar të gjitha sistemet primare shëndetësore në nivel vendi në kohën më të madhe të luftimit epidemiologjike në 100 vitet e fundit. Pra janë tërhequr të gjithë mjekët prej shërbimit primar shëndetësor dhe kanë shkuar në QKUK, adresa për këtë është në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe është dashur të tërhiqen mjekët specialistë dhe me i sjellë në QKMF.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, pyetje për drejtorin e DSHMS, si e arsyeton largimin e mjekut specialist nga AMF-ja në fshatin Herticë ose fshatit Dyz me dërgu në fshatin Kërpimeh, ku jeni bazuar për lëvizjen e mjekëve specialistë dhe a i keni shkelur të drejtat e njeriut.

Ju jeni menaxher i shëndetësisë dhe duhet të mësoni dallimin mes shërbimit dhe menaxhimit.

znj.Adelina Stublla, theksoi, sa i përket shërbimeve të Mjekësisë Familjare është funksionalizuar qendra anti covid e përbërë prej 40 profesionistëve. Sa i përket aksidentit që ka ndodhur, ky aksident ka ndodhur si shkak se kanë vepruar ekipet në terren dhe zakonisht këto shërbime janë kryer për pacientët që s'kanë mundur të vijnë deri në qendrën anti covid, që kanë qenë në gjendje të rënduar dhe këto shërbime janë kryer në shtëpi.

Sa i përket mbylljes së ambulantave e shpjegoi drejtori i DSHMS se kjo ka ndodhur për shkak të shkuarjes së mjekëve në specializim ku Ministria e Shëndetësisë e menaxhuar në atë kohë nga ministri z.Armend Zemaj ka dhënë specializime vetëm ashtu, çështje fushate, sepse nuk është dashur aq shumë sepse specialistët tanë janë duke qëndruar nëpër korridore kot ngase nuk kanë hapësirë për ta marrë mësimin e duhur, kështu që sa i përket mbylljes së ambulantave në kohën e pandemisë ka qenë çështja e mungesës së stafit mjekësor, kurse tani janë të gjitha ambulatat e hapura dhe përveç fshatit Dumnicë dhe fshatit Dobratin që lidhen dhe janë në hapje e sipër, shërbimet kryhen edhe në teren dhe atë në 12 orë pune.

z.Hasan Ajeti, theksoi, për mjekësinë duhet të flasim në një seancë tjetër që po mendoj që duhet me qenë e jashtëzakonshme, realisht është punuar shumë por nuk mund të lexohen specializimet me terma të tillë siç u ceken, fundja nuk është e saktë ajo, prandaj më mirë ta përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës. Unë e shohë të arsyeshme që në seancën e ardhshme të jetë e jashtëzakonshme sepse edhe ju keni përgjigje por edhe ne kemi pyetje, kështu që e bënë një punë thuajse me produktivitet në fushën ku ju e udhëhiqeni.

z.Agron Hyseni, theksoi, u fol goxha shumë për shëndetësi për shkak të një pyetje, drejtori i DSHMS-së e dha një përgjigje që kanë shkuar në specializim 12 mjek, pyetja ime është sa është numri i mjekëve që punojnë. Shumica e ambulanteve edhe në kohën e mëparshme kanë funksionuar, shembull, dy herë mjekun gjatë javës ka qenë në atë ambulancë, mirëpo infermierët nuk kanë shkuar në specializim kanë mundur me qenë të hapura dhe me kryë shërbime që i kryejnë infermierët jo vetëm mjekët, prandaj unë mendoj që ka qenë ndoshta mos organizim dhe mos menaxhim i mirë për shkak se i keni mbyllur, e që nuk është dashur t'i mbylleni. Infermierët i keni pasur dhe keni mundur të paktën 1 infermierë ta dërgoni në ambulancë, madje të paktën me qëndru aty një gjysmë orari, nëse keni pasur problem me staf kjo nuk ka të bëjë fare me atë që të mbyllën ambulatat për shkak të mjekëve. Të mbyllën 12 ambulanca kjo është absolutisht e pa pranueshme dhe është mos menaxhim i mirë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me që nuk ka të lajmëruar tjerë për ta marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit Konstatoi se NJËZËRI (me 33 vota) miratohet propozim Vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë- 38

9. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, rreth gjendjes së Pylltarisë në territorin e Komunës së Podujevës

z.Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Administratës - DA, theksoi, në mungesë të drejtorit të Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i cili është pjesë e delegacionit të Komunës që po qëndron në Bursa të Republikës së Turqisë, dhe këtë po e ndërlidhi edhe me këshilltarin zotëri Llapashtica sa për njoftimin e tij që ky delegacion po qëndron zyrtarisht në qytetin Bursa të Turqisë për lidhjen e një Memorandumi për binjakëzim me Komunën e Podujevës.

Sa i përket informatës, besoj se të gjithëve ju është dërguar dhe keni pas kohë ta lexoni dhe analizoni, andaj unë nuk po dëshiroj tani që t'ju lexoj gjithë informatën sepse janë të shkruara dhe është një Informatë e përgatitur prej drejtorit të Drejtorisë në fjalë, mirëpo do të mundohem që në pyetjet dhe sugjerimet e juaja t'ju jap përgjigje për aq sa kamë edhe unë informata dhe njohuri rreth çështjeve të caktuara në kuadër të DBPZHR, mirëpo për të gjitha ato çështje për të cilat unë eventualisht nuk mund të jap përgjigje sot, të jeni të bindur që drejtori i DBPZHR ose do t'ju

përgjigjet në seancën e radhës – në pikën të ndryshme, ose do t’ju kthej përgjigje dhe sqarime me shkrim në e-maillet e Juaja.

z.Hasan Ajeti, theksoi, realisht kemi të bëjmë me një raport pune të DBPZHR me theks për pjesën e sektorit të pylltarisë, pra një përshkrim i detyrave të punës që i kryejnë zyrtarët, por gjithsesi duhet falënderuar sepse po të mos ishte edhe ky raport atëherë që informata do të ishte boshe.

Është befasisëse se si nuk flitet për bujqësinë që ka qenë temë jo vetëm nga subjekti jonë politik, duke ditur rëndësinë që ka për Komunën e Podujevës, e që do të ishte mirë që në këtë informatë drejtori të na tregonte se çfarë punësh janë bërë për këtë periudhë të vlefshme për Komunën, pasi drejtori i DBPZHR, gjykoj se nuk është aq transparent sepse vetë raporti në fjalë është një informatë të cilën unë ashtu e lexoj dhe në këtë aspekt pyetjet që unë i kam kanë të bëjnë realisht me bazën e vendimeve që ai i ka marrë e që del të jetë si në pozitën e Nënkryetarit e që realisht tani po e kuptoj se de fakto, po jo de jure, qenka Nënkryetar i Komunës.

Fillimisht ka të bëjë me anulimin e listës së motokultivatorve, interesante kjo sepse drejtori i DBPZHR anulon vendimin e Kryetarit të Komunës e që referuar ligjit për anulimin apo shfuqizimin e një akti e ka të drejtën vetëm organi i cili e nxjerrë atë e që në këtë rast është Kryetari i Komunës, do të thotë se në bazë të asaj që ka vepruar drejtori i DBPZHR del që është Nënkryetar i Komunës, shikojeni njoftimin ku thuhet Njoftim për anulimin e projektit për motokultivator me arsyetim se OSHP paska anuluar procesin e prokurimit për shkak të ankesave të Operatorëve Ekonomik, mirëpo ai drejtor është dashtë ta dinë se çka është OSHP, çka trajton OSHP, a është kompetencë e OSHP-së që t’i anuloj vendimet e pushtetit lokal, a janë kompetencë lëndore dhe funksionale e drejtorëve, e që po ju garantoj këtu se ai drejtor nuk i dinë, mirëpo ai drejtor edhe përkundër një emri që e ka Vigan, në punë vërehet se kryen punë praktike, andaj ajo çka ka bërë ai është shkelje sepse OSHP është organ që i shqyrton ankesat e operatorëve ekonomik dhe nuk është kompetencë e OSHP-së të anuloj vendime të Komunës.

Nuk ndihmohen bujqit kështu, përkundrazi duke përcjellë mesazh përjashtues e që kjo lëndë, dorën në zemër siç e thotë populli, është për hetim. Të njëjtin parim dhe të njëjtin standart e keni përdorë kur ka pas të bëjë me listën e bursave për nxënës dhe studentë e që ka nuk ka qenë aspak transparent sepse ka publikuar listën e dytë në momentin kur ne kemi qenë këtu në seancë, gjë të cilën mund ta shikoni secili prej jush dhe mund të shihni se ka ndryshim dhe ku mbetet pastaj transparenca në këtë rast, në cilën shkollë janë ata nxënës përfitues të bursës, kush janë ata, a u rritë numri, ku u siguruan mjetet buxhetore tani, asnjë nuk figurojnë në atë listë, ndërsa këtu në seancë drejtori i DKA-së ka thënë se janë 50,000.00€, prandaj këtu shihet se nuk ka transparençë. Anulimi i vendimit nga drejtori i DBPZHR është i kundërligjshëm sepse nuk ka të drejtë që drejtori t’ia anuloj vendimin e Kryetarit, kjo është absurde.

Pastaj është nënshkruar një kontratë për furnizim me mëshqerra në vlerë prej 112,000.00€, janë 70 krerë lopë, dhe po të llogaritim i bie që një lopë kushton 1600.00€, shto këtu edhe 30% të participimit nga pjesëmarrësit / përfituesit nga ky subvencion, kush është menaxher i kësaj kontrate e cila është lidhë më 24 maj 2021 dhe që është dashur që sipas obligimit ligjor pas 3 ditëve duhet të caktohet menaxheri i kontratës sepse ai është personi i cili i dinë specifikat mbi cilën është shpall tenderi, do të thotë edhe këtu nuk ka përgjigje, mandej a kanë filluar dërgesat ashtu sikurse parashihet me ligj që 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës fillojnë dërgesat, ndërsa sot jemi më shumë se 10 ditë, do të thotë nuk kanë filluar dërgesat, pra këto janë çështje shumë serioze dhe pyetje për drejtorin e DBPZHR edhe pse ai nuk është këtu prezent, por keni parë këtu para Komunës edhe fermerët, mandej pyetja është se a janë ardhur lot sipas specifikave.

Pastaj kemi edhe pyetjen tjetër lidhur me furnizimin me serra 50m², pse kjo sipërfaqe kaq e vogël, shembull por t’ju ofrohet bujqve në fshatin Sfeçël serra 50m², do t’ju tregojnë se çfarë duan,

mirëpo nuk i ka pyetur fare drejtori bujqit por ka punuar vetëm kokë në vete mirëpo kjo është edhe më keq dhe pyes që a është e vërtetë se operatori ekonomik që e ka fituar atë tender ka shpreh shqetësim se për shkak të ngritjes së çmimit nuk mund ta implementoj kontratën, pra a është e sak, si do të zgjidhet kjo çështje dhe cilat janë penaltitë ndaj atij operatori, çështje këto të cilat janë të cekura në kontratë dhe jemi në dijeni se në kontekstin e kushteve të përgjithshme gjithëherë mbizotërojnë kushtet e veçanta të kontratës, prandaj drejtori është dashtë të jap sqarime.

Edhe një çështje e cila është në interes të qytetarëve por edhe në interes tonin kuptohet si anëtar të Kuvendit, sepse jeni thirr gjithmonë në transparencë, është furnizimi me drunj dekorativ, janë vendosur në një pjesë të Sheshit dhe tani me emblemën e ekspertëve të fushës, por është shumë lehtë të dihet kjo vetëm të merret përshkrimi i specifikacionit që ka qenë dhe mund të jep përgjegjësi dhe përgjigje secili nga Drejtorisë gjegjëse veç e veç, mirëpo veprimet e këtij drejtori të DBPZHR deri sot janë të kundërligjshme i nderuar kolegë Ragip Fetahu që tani po të drejtohem juve sepse ti po mbahesh si krah i LVV-së dhe po ndërhyjnë nganjëherë.

z.Ragip Fetahu, replikë me parafolësin, fillimisht kur flasim për transparencë e dim që për 20 vite në çka është bërë transparenca. Çështja tjetër është se për drejtorin e DBPZHR edhe unë i kam disa pyetje për të cilat duhet të përgjigjet ai, por sot këtu nuk është prezent.

Informata që e ka sjellë drejtori i DBPZHR është e pa plotë, është informatë e përgjithshme, por është dashtë të na ofroj plane konkrete se çfarë është duke bërë pyllëzim dhe çfarë është duke bërë për shumë projekte dhe plane tjera, dhe për këtë pajtohem, ndërsa për çështjet e tenderëve dhe çështjeve tjera që parafolësi Hasan Ajeti i ceku ndoshta edhe nga cilësia që është jurist dhe i njeh më mirë ato çështje, unë mendoj se veç transparencë drejtori i DBPZHR ka, nëse nuk ka asgjë tjetër, dhe jam në dijeni se është ekspertë i bujqësisë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, rreth asaj që parafolësi e ceku se për 20 vite nuk ka pas transparencë, Kryetarin e Komunës që sot e keni, për 7 vite ka qëndruar në Ekzekutiv.

Çështja tjetër, këto pyetje që unë i parashtrova janë pyetje legjitime dhe askush nuk duhet t'i merre si politike. Unë i them se është anulim i kundërligjshëm që është bërë për motokultivatorët sepse nuk është kompetencë e drejtorit një gjë e tillë dhe nuk është domosdoshmëri të jesh jurist dhe t'i kuptosh këto çka unë i ceka.

Pastaj kontratat janë publike, dhe nëse kontrata për furnizim me mëshqerra e cila është nënshkruar muajin e kaluar, janë kushtet e përcaktuara dhe duhet sqaruar dhe japur përgjigje, pra janë punë teknike vetëm të na tregoj neve a janë ardhur apo nuk janë ardhur lopët, këtu nuk kemi të bëjmë me diploma apo se a është ekspertë apo jo, e që nëse nuk gabo, ai person punën dhe eksperiencën e parë e ka këtu në komunë, dhe atë si drejtor.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nëse i referohemi këtij dokumenti që e ka sjellë drejtori i DBPZHR, ai ka bërë një informatë për pylltari, kurse tani këtu po diskutohet edhe për blegtori dhe për bujqësi. Drejtori në Informatën e sjellë, na ka treguar sa kubik dru janë prerë, sa janë nxënë (konfisku) dhe sa gjoba janë shqiptuar nga pylltarët. Mendoj se sa do që hyjmë në debat më të thell sot rreth kryerjes së detyrave sepse drejtori e ka sjellë raportin tremujor të i DBPZHR, kështu që siç e ceku edhe këshilltari parafolës z.Ragip Fetahu i kemi disa pyetje direkte për të cilat mund të sqarohemi gjatë debatit por që nuk po dua t'i drejtohem drejtorit të Drejtorisë së Administratës për çështje të DBPZHR edhe pse do të doja që ai drejtor që merr përsipër çështje të ndonjë Drejtorie tjetër të ketë informata të mjaftueshme për të jap përgjigje nda pyetjeve të këshilltarëve sepse nuk mund të funksionohet kështu.

Për ta kryer punën e vet drejtori i DBPZHR është dashtë të na tregoj për subvencionet e ndara fermerëve, për shërbimet e kryera, për ekzaminimet e dheut të tokës dhe me një plan të detajuar.

E them këtë sepse këshilltari z.Ragip Fetahu e tha se drejtori i DBPZHR është transparent dhe ekspert i fushës, ai mund të jetë ashtu dhe mund të jetë djalë i mirë por mund të jetë menaxher i pa aftë. Për mua një drejtor i tillë i cili fole për bujqësi, pylltari, blegtori dhe që i përfshinë të gjitha në një fushë sikurse Naim Frashëri që ka shkruar dhe janë kënduar këto gjëra, dhe dokumentin që e ka sjellë ai drejtor ka treguar një paqartësi të madhe sepse nuk ka ditë të tregoj asgjë, ndoshta ndërrijen e ka, mirëpo unë këtu i tregoj atij që, shembull te parku i pishave janë duke u prerë pishat, janë duke u bërë metra për djegje dhe duke u shitur, dhe atë ku këtu në mes të qytetit e lëre të mos flasim për pjesë të thella malore e pyjor.

Asnjëherë nuk i kam kundërshtuar udhëtimet zyrtare qoftë të Kryetarit qoftë të ndokujt tjetër sepse Kryetari i Komunës është e nevojshme të lëvizë në shtete dhe qytete të përparuara dhe të merre modele, mirëpo edhe ju sa ishit në opozitë (i drejtohet drejtorit të Drejtorisë së Administratës) e keni kritikuar ish Kryetarin e Komunës që i merrke me vete 5-6 zyrtarë të ndryshëm të Komunës, ndërsa tani thonë që drejtori i DBPZHR do t’jua kthejë përgjigjet përmes e-maili, ndërsa ju në atë kohë kërkonit përgjigje me letra. Ndoshta jemi bërë paska “bajat” me seanca të jashtëzakonshme dhe asnjëherë nuk kam qenë ithtarë i thirrjes së tyre, mirëpo me të vërtetë tani është e nevojshme të thirret një seancë e jashtëzakonshme për arsye se e gjithë LVV-ja mendon që drejtori i DBPZHR është shumë i mençur, deri sa të ballafaqohet me dikë drejtpërsëdrejti me argumente, fakte dhe ligjshmëri të veprimeve të marra.

Vendi më i afërt për blegtori në Evropë është Holanda e cila eksporton gjedhe profitabile familjare të një cilësie shumë të lartë që edhe BE-ja ka dal me një solucion cilësor, por që nuk e mbërrin shumën prej 1800.00€ që një lopë të vie këtu në Kosovë, e cila prodhon 28 litër deri në 32 litër qumësht në ditë, prandaj drejtori i DBPZHR mendon që askush nuk lexon për bujqësi dhe nuk i dinë gjërat. Si do që të jetë ne përmes kësaj Informate e kuptuam sa kubik dru janë prerë, sa gjoba janë shqiptuar nga pylltarët, ndërsa për çështjet tjera të bujqësisë pylltarisë dhe fushave tjera n’kuadër të kësaj Drejtorie siç janë subvencionet e serave dhe çfarë do të bëhet me këtë projekt, pastaj me mbjelljet pranverore, kompensimet etj etj, mendoj se i takon një seance tjetër kur drejtori do të jetë prezent kur do që ka kohë. Prandaj kjo është vetëm një informatë, votim për këtë nuk ka, kështu që e mbyllim këtë debat sepse vetëm zgjatet pa nevojë dhe kalojmë në pikën e radhës.

z.Mehemet Gashi, theksoi, lidhur me çështjen që e potencoj parafolësi z.Rafet Llapashtica rreth prerjeve në parkun e pishave unë hiç më larg se një ditë më parë e kam parë vetë gjendjen atje dhe shumë perona më kanë ndalë dhe më kanë pyetur se çfarë është duke ndodhur me këto prerje dhe me traktor duke marrë dru-pisha. Mua mu dasht të prezantohem si këshilltar i Kuvendit para asaj Kompanie dhe t’i pyes se çfarë jeni duke bërë me këto prerje, a keni ndonjë vulosje se cilat të prehen dhe cilat jo apo vetëm sipas dëshirës po preni pisha dhe drunj për t’i shitur sepse aq sa di unë kërkesa ka qenë vetëm për ata lisa dhe pisha që janë rrëzuar nga bora por jo për prerje të tillë masive për të shitur për dru zjarri, përgjigja e tyre ishte se ka qenë para 3-4 ditëve drejtori i DBPZHR dhe na ka thënë t’i prejm disa që janë të thata dhe që janë tjera të ngjashme. E gjithë kjo po bëhet pa mbikëqyrje, nuk ka ditë që nuk dal në atë park dhe shkoni e vizitoni edhe ju dhe sigurisht do t’ju dalin mbi 100 lisa e pisha të mëdhenj që janë prerë dhe janë dike i shitur, ndërsa neve na thuhet vetëm disa të thata po i prejm ashtu siç na ka thënë drejtori. Është mirë që secili prej këshilltarëve të kuvendit të del dhe ta shohë gjendjen në atë park i cili është i qytetit dhe është për qytetarë, ndërsa të bëhet në atë gjendje unë besoj se nuk mund të kaloj pa dhënë përgjegjësi dikush. Sa jam në dijeni në kuadër të DBPZHR është zyrtari ekspert për pylltari i cili i shikon dhe i vulos drunj të cili duhet të prehet cili jo. Nuk jam në dijeni se si kanë qenë paramasat, vetëm për ata drunj/pisha që kanë qenë të dëmtuar apo edhe për drunjë tjerë, andaj është mirë të sqarohemi për këtë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vërtetë është shqetësuese prerja e pishave në parkun në fjalë sepse jemi në dijeni të gjithë që në atë park kanë qasje edhe ndërkombëtarët që nga paslufta, andaj duhet pasur kujdesë sepse është i vetmi park i qytetit që e kemi sot, e sidomos për të ardhmen.

z.Agron Hyseni, theksoi, deshta të ndërldhem paska me diskutimin e këshilltarit z.Ragip Fetahu i cili foli për transparencë, unë e sugjeroj kolegun e nderuar dhe gjithë Ekzekutivin e Komunës për prokurimin e Komunës së Podujevës që një projekt të zvarritet për 5 muaj dhe pas 5 muajve të lidhet kontrata. Ju si pushtet që qeverisni bashkërisht me këshilltarët e Kuvendit, pyetni drejtorët e Drejtorive të atyre projekteve, të cilët fatkeqësisht nuk janë këtu prezent, dhe mund t'i pyetni edhe se a është lidh kontrata në mënyrë të jashtëligjshme sepse është kaluar afati i vlefshmërisë së ofertave dhe është nënshkruar jashtëligjshëm kontrata për furnizim dhe e cila kap një shifër bukur të madhe. Prandaj sa i përket transparencës, na pati lodh duke thënë prokurimi, prokurimi, prandaj i nderuar (i drejtohet z.këshilltarit z.Ragip Fetahu) pyetni bashkëpartiakët tuaj për këto çështje sepse nuk ka transparencë në këto projekte.

z.Ragip Fetahu, theksoi, i nderuar Agron Hyseni fillimisht ju nuk e specifikuat për çka bëhet fjalë e që do të duhej sepse nuk mund të shikohet vetëm ashtu si të them në ajr.

Çështja tjetër, sa i përket transparencën ende nuk është bërë vlerësimi i përgjithshëm i qeverisjes aktuale lokale dhe nuk kemi të dhëna zyrtare, mirëpo e dimë raportin e transparencës që tash vonë doli se si është për vitin e kaluar dhe sa përqind ka dal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa i përket raportit të performancës së shpejti do ta kemi për diskutim në Kuvend rreth atyre të gjeturave, mangësive dhe përparësive që kemi si Komunë.

z.Agron Hyseni, theksoi, drejtorët e Drejtorive përkatëse nuk janë këtu prezent e që sigurisht kam dëshirë t'i dëgjoj edhe ata rreth çështjeve që ngritën. Sigurisht se do të organizohet edhe një seancë e jashtëzakonshme për ato shqetësime të cilat janë bukur serioze dhe ka shkelje flagrante në prokurim dhe do ta marrësh vesh i nderuari Fetahu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalë, këtu prezent nuk është drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për të dhënë sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme por që sigurisht se do t'i përcjellën atij posa të kthehet nga udhëtimi zyrtar në Republikën e Turqisë. Prezent është drejtori i Drejtorisë së Administratës si pjesë e Ekzekutivit të Komunës cili ka diçka për të thënë rreth çështjeve që u ngritën.

z.Bahri Selimi, drejtor i DA, sigurisht që kjo seancë u stërgjatë paksa dhe jemi të lodhur paksa, mirëpo ashtu siç edhe e ceka në fillim të kësaj pike që për të gjitha shqetësimet, pyetjet dhe çështjet e ngritura për të cilat kam njohuri dhe informata do të mundohem t'ju jap përgjigje, dhe po filloj prej këshilltarit z.Hasan Ajeti rreth pyetjes për anulimin e listës së përfituesve të motokultivatove, kjo është pyetje e cila i përket fushës së bujqësie kurse informata ashtu siç e ceka edhe në fillim ka të bëjë vetëm me fushën e pylltarisë, prandaj brenda kësaj informate mendoj se do të merrni përgjigje, por jo për ato çështje të cilat nuk janë të parapara në këtë informatë, madje shpresoj se së shpejti drejtori i DBPZHR do ta paraqes edhe raportin për bujqësi dhe zhvillim rural sepse jeni në dijeni se Drejtoria në fjalë është e ndarë në fusha dhe sektor të caktuar e që nuk janë paraqitur informata përnjëherë për të gjitha ato fusha, por të jeni të bindur se do të paraqiten edhe ato sepse ashtu ka qenë e planifikuar edhe më parë.

Sa i përket furnizimit me drunj dekorativ, jemi të njoftuar sepse është shpall njëherë fituesi i tenderit dhe nga papërgjegjësia e tij ne nuk jemi duke pranuar drunjtë që ai operator i ka ofruar, pikërisht për këtë arsye është duke u zvarritur situata, madje tani ndaj atij operatori janë duke u përgatitur masa ndëshkuese të cilat parashihen ndaj një operatori të papërgjegjshëm, operator i cili ka sjellë disa drunjë, ka dashtë të filloj procesin e mbjelljes së tyre mirëpo nuk kanë qenë konform specifikacionit të paraparë, madje më saktësisht në specifikacion kanë qenë 8 deri në 10cm të

diametrin të trashësisë së drunit, ndërsa ata janë sjellë 5 deri në 6cm, prandaj ne nuk e kemi pranuar një gjë të tillë dhe ky si proces sigurish se do të zvarritet derisa të sjellën drunjtë mirë ose jemi duke menduar që si tender ta anulojmë të tërin dhe ta rishpallim sërish, por për korrektësi operatori përkatës ka kërkuar t'i shtyhet afati deri në kohën e vjeshtës kur është e përshtatshme për mbjelljen e drunjtëve mirëpo kjo tani varet prej Drejtorisë dhe prej raporteve që krijohen mes dy palëve kontraktuese.

Sa i përket prerjes së drunjtëve te parku i pishave, unë me përgjegjësi ju them se nuk jemi të njoftuar për atë që u tha dhe se nuk ka prerje ashtu siç po paraqitet këtu, mirëpo për atë park është hapë një lloj tenderi me tri oferta dhe në bazë të tij një operator ekonomik ka pastruar atë pjesë sepse jeni në dijeni se ka pasë rrëzime dhe thyerje të drunjtëve nga erërat dhe ne kemi qenë të obliguar që ta pastrojmë parkun e pishave pikërisht për faktin që në atë park ka qarkullim dhe frekuentim të qytetarëve të cilët dalin për ecje, kështu që jo i nderuar këshilltar zotëri Mehmet Gashi dhe këshilltarë tjerë. Ne kemi kërkuar që të konkurron ndokush për të pastruar atë pjesë dhe tani nuk mund të them 100% se ai operator është marrë vetëm me pastrim, ndoshta edhe e ka prerë ndonjë dru, por megjithatë është bërë përpjekje që ai park të pastrohet prej drunjve të thyer nga era dhe disa drunjve të thatë prej të cilëve nuk ka pasë dobi e të cilët është dashtë të hiqen. Pra e tëra ka qenë kjo që e potencova, por sërish nuk mund të them me përgjegjësi të plotë që nuk ka mund të ketë prerje edhe të ndonjë druri sepse ka mund ta prej ndonjë që nuk ja ka vlej të prehet.

I nderuar zotëri Rafet Llapashtica, jeni në dijeni shumë mirë që kur parashtroni pyetje drejtori ka mundësinë që t'ju jap përgjigjen pastaj në formë të shkruar përmes e-maili, madje edhe nëse e ka përgjigjen aty për aty sepse është e drejtë e drejtorit kjo dhe ndoshta dëshiron t'ju përgjigjet në formë të argumentuar me shkrim, prandaj nuk e di përse po merret kjo kaq tragjike pse nuk është drejtori i DBPZHR këtu prezent dhe nuk po kemi përgjigje nga ai, apo po e dëshironi debatin sepse me shkrim pastaj është paksa më vështirë të debatohet.

z.Rafet Llapashtica, nga vendi reagon, edhe ju drejtor i DA-së zotëri Selimi) keni thënë para disa seancave se përgjigjet do t'jua kthej me shkrim mirëpo nuk e keni bërë një gjë të tillë.

Sa i përket përgjigjeve për parkun e pishave, unë ende pa e shtruar pyetjen e di përgjigjen tuaj sepse jam i bindur se nuk e ke vizituar parkun e pishave dhe nuk ki informata për prerjen e drunjtëve dhe pishave, prandaj nuk po dëshiroj të hyjë në debat me ty si drejtori i DA-së. Çështja tjetër, jeni në dijeni se komuna bënë pastrimin e pyjeve dhe atë përmes tenderëve, pyetja është a ka bërë komuna markimin-vulosjen e drunjtëve që duhet të prehen në atë park, përgjigja është jo. Nëse edhe vetëm një dru është prerë që nuk është dashtë të prehet ai operator duhet të gjobitet dhe të ndërmerren masa.

z.Bahri Selimi, drejtor i DA, vazhdoi, edhe njëherë po ju them se për çka do që keni pyetje dhe shqetësime lidhur me temën që po diskutojmë lirshëm mund të paraqitni dhe ju siguroj se do t'i merrni përgjigjet nga ana e drejtorit të drejtorisë përkatëse. Sa i përket çështjes së transparencës të cilën e shtroj këshilltari z.Agron Hyseni dhe pati debat, unë nuk e di dhe jam goxha shumë i bindur që ka ndonjë tender për të cilin nuk është nënshkruar kontrata që 5 muaj. Këtë e them edhe për faktin se ne këtu si qeverisje e re jemi që 5-6 muaj, dhe çdo procedurë e tenderit zgjatë 90 deri në 100 ditë apo rreth 3 muaj e gjysmë, kurse ne jemi duke qeverisur që 5 muaj ndërsa ju po thoni se që 5 muaj nuk është nënshkruar kontrata, pra kjo ishte një ndërlidhje në baza matematikore prej kohës kur kemi ardh ne, ndërsa për Prokurimin publik, ai është i njëjti dhe nuk ka ndërruar asgjë nga ai që ka qenë në pushtetin e kaluar, por t'ju them të drejtën në bazë të një raporti të prokurimit që është bërë tash së voni me USAID del që nga janari deri më tani mbi 85% projektet janë të iniciuar, ndërsa në vitin paraprak për këtë periudhë të njëjtë kohore përqindja e inicimit të

projekteve ka qenë 25%, kështu që mund të filloni edhe me prokurimin por përgjigjet do t'ju jem menjëherë.

z.Agron Hyseni, theksoi, i nderuar drejtor Selimi, për çështjen që unë po diskutoj është e vërtetë se inicimi i procedurës së prokurimit është bërë para se të ndërrohet pushteti, por ju si vazhdimësi e menaxhimit me Komunën është dashtë t'i përfillni procedurat e rregullta dhe nëse nuk do të kryheshin ato proceduar brenda 90 ditëve për nënshkrim të kontratës, por edhe vlerësimi i ofertave është stërzgatur shumë sepse më 29 dhjetor është nisë projekti dhe e keni stërgjatë e stërgjatë, ndërsa kontrata është lidhë para 2-3 ditëve, prandaj a e konsideroni veten përgjegjës. Ku të vije drejtori i DBPZHR do t'i qesim faktet dhe argumentet në tavolinë dhe do ta shohësh edhe ti drejtor (i drejtohet z.Bahri Selimit).

A është në rregull kjo, tërë kohen edhe e keni sponsorizuar në rrjete sociale të plasoni lajme për këtë prokurim dhe ta promovoni sa më shumë një video që ka qenë, ndërsa tanoi po del e kundërta sepse nuk paska qenë ashtu qysh ju keni thënë sepse ti drejtor me fjalë t'juaja po e mbron një prokurim të cilin në vazhdimësi e keni përqesh. Stërzgjatja e procedurave të prokurimit keni thënë se është pazar, kurse tani a po i bie se është pazar stërzgjatja e asaj procedure.

Edhe një pyetje, a mund të më tregoni sa kohë ka kaluar implementimi i projektit për sera, konkretisht a ka kaluar koha që është në kontratë për fillimin e punimeve për ndërtimin e atyre serave, nëse është kaluar dhe nëse nuk janë nisë me kohë të ndërtohen a është dashtë të merret një vendim për penalizim për moskryerje të punës, a po mendoni se në muajin shtator fermerët fillojnë mbjelljen sipas planifikimeve të tyre, prandaj kjo nuk është në rregull.

z.Mehmet Gashi, theksoi, kam replikë të shkurtër me drejtorin e DA-së edhe pse ky nuk është drejtor në atë sektor për të cilin po diskutojmë n'kuadër të DBPZHR, megjithatë unë edhe nga përvoja e di se për çdo projekt dhe çdo kontratë që lidhet është edhe menaxheri i projektit për mbikëqyrjen e kontratës, mirëpo unë nuk kam parë asnjëherë në parkun e pishave që ka ndonjë menaxher që ka dal të kontrolloj punimet në parkun e pishave. Unë mbaj përgjegjësi për atë që e potencova më diskutimin e mëparshëm dhe për atë mund edhe të dilni dhe shikoni çfarë është duke u bërë atje. Po të ishte menaxheri i kontratës sigurisht se do të dilte dhe të kontrollonte punimet dhe do të markonte drunjët për prerje, mirëpo i janë lënë duart e lira operatorit që të prej drunjë në parkun e pishave. Unë nuk i kam numëruar sa drinjë/trupa janë prerë, por mund të them se të paktën janë mbi 100 trupa që janë prerë dhe kjo mund të verifikohet sepse aty janë rrënjët, prandaj po e them se janë prerë ata drunjë/pisha pa kurrfarë kontrole, madje janë dëmtuar edhe drujtë/pishat tjera sepse gjatë prerjes në rënie e sipër kanë dëmtuar tjerët si pasojë e prerjes pa kurrfarë kontrole. Prandaj unë fillim e thash se drejtori i DA-së nuk e ka në kontrollë atë sektor, por të paktën kërkoj të mos e arsyeton DBPZHR dhe të thotë se çdo gjë është në rregull, por mund të dilni dhe të shikoni gjendjen në terren dhe pastaj të flisni.

z.Bahri Selimi, drejtor i DA-së, theksoi, e thash njëherë se nuk e marrë përgjegjësinë të them se nuk ka ndodh diçka për çka po flitet në parkun e pishave ngase po e përsëris se operatori e ka sharrën në dorë dhe mund të ketë prerë edhe ndonjë dru që s'ka qenë e nevojshme për ta prerë, apo siç e thotë populli "krahas të thatit pëson edhe ndonjë i njomë" dhe ka mund të ndodh kjo.

Gjithashtu rreth çështjes së ngritur nga këshilltari z.Agron Hyseni, sa unë jam në dijeni procedurat e prokurimit nuk zgjatin vetëm 90 ditë sepse është edhe procedura e ankesës e cila mund të zgjatë me muaj madje, pra vetëm procedura e inicimit është 90 ditë, mandej është afati i ankesës, afati i shqyrtimit të ankesës dhe mund të shkoj deri në 6 muaj një procedurë e prokurimit, ndërsa nëse ju i nderuar Hyseni nuk keni marrë informacione dhe nëse nuk e keni ditur këtë është çështje tjetër.

z.Agron Hyseni, theksoi, edhe njëherë po e përsërisë këtë çështje, 30 ditë janë afat për vlerësimin e ofertave, me përjashtim të ndonjë rasti kur me kërkesë të arsyetuar të prokurimit mund të shtyhet edhe 10 ditë më shumë, pra janë 40 ditë e jo 3 muaj i nderuar drejtor, pastaj nëse ka ankesë procedura shkon deri në 90 ditë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës u diskutua mjaft, u paraqiten pyetje, shqetësime dhe çështje të ndryshme, andaj do të ishte mirë që t'i përcillen këto pyetje dhe shqetësime drejtorit të Drejtorisë përkatëse në mënyrë që varësisht mundësisë dhe vullnetit të tij t'iu kthehen përgjigjet këshilltarëve të Kuvendit, prandaj meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës.

10. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i ngritur me Vendimin nr.prot.01-500/01-0087376/18 datë 02 nëntor 2018 (zëvendësimi i një anëtari)

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së dhe është dhënë dhe rekomanduar zëvendësimi i anëtarëve për këtë Komitet, andaj lus të propozohet edhe njëherë para Kuvendit në mënyrë që të jenë të informuar edhe këshilltarët tjerë që nuk janë pjesë e KPF-së edhe pse konstatimet u janë dërguar me kohë dhe keni pas kone të mjaftueshme t'i lexoni.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, për anëtar në këtë Komitet e propozojmë z.Ragip Fetahun në vend të ish anëtarit z.Vendenis Lahu i cili është zgjedhur Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nuk është më pjesë e Kuvendit.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i ngritur me Vendimin nr.prot.01-500/01-0087376/18 datë 02 nëntor 2018, përkatësisht z.Ragip Fetahu emërohet në vend të ish anëtarit z.Vendenis Lahu i cili është zgjedhur Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nuk është më pjesë e Kuvendit.

11. Të ndryshme

z.Agim Behluli, theksoi, kam një çështje për të ngritur dhe ka të bëjë me sigurinë publike ku janë të vendosura kamerat e sigurisë në qytet, çështje për të cilën në atë kohë ishte bërë e madhe kjo punë, mirëpo tani nuk janë funksionale shumica prej tyre, rreth 60% e tyre, kjo është pyetje për drejtorin e Drejtorisë përkatëse.

Pyetja e dytë ka të bëjë me propozimin tim para 2-3 seancave nëse nuk gaboje që ka pas të bëjë me dhënien e ndihmës financiare familjeve që iu janë vdekur familjarë të tyre nga Covid-19, andaj pyes deri ku ka shkuar ky proces.

z.Hasan Ajeti, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës, pak më herët gjatë një pauze këtu në oborrin e Komunës vërejtja një veturë Peugeot e cila kishte të ndërruara targat, nga 01Z... që ka qenë ish bërë 01...., andaj cila është arsyeja e ndërrimit të atyre targave.

z.Bahri Selimi, drejtor i DA-së, përgjigje në pyetjet e parafolësve, theksoi, sa i përket funksionimit të kamerave të sigurisë në qytet sigurisht jeni në dijeni se ato kamera menaxhohen nga Stacioni i

Policisë në Podujevë por megjithatë disa prej tyre kanë qenë në defekt më përpara kurse disa prej tyre tani është dashtë të ç'kyçen prej sistemit për shkak të ri fillimit të punimeve në sheshin e qytetit, mirëpo si pajisje ekzistojnë dhe me përfundimin e punimeve në shesh ato kamera do të riaktivizohen. Disa kanë qenë në defekt dhe jemi marrë me atë çështje ku ekipet kanë qëndruar në terren për një kohë të gjatë dhe tani së fundmi është dashtë sërish të hiqen ato kamera sepse është duke u punuar në ndërtimin e sheshin e qytetit.

Sa i përket ndërrimit të targave për një veturë zyrtare, kjo çështje ish e rregulluar me dispozita ligjore që një automjet mund t'i ketë dy palë targa, dhe në këtë aspekt ka qenë kërkesë e Kryetarit të Komunës i cili vozitet me një Peugeot dhe nuk vozitet me atë gjipin e zi të madh sepse shpenzimet janë shumë të mëdha, sinqerisht po ju them se gjipi i zi rrinë këtu i parkuar dhe shumë rrallë ndezët për arsye se këtë gjë e dinë më së miri babi i asambleistes i cili menaxhon me këtë çështje (fjala është për babain e anëtares së kuvendit Valbona Kadriu), pra harxhimet ai gjip i ka deri në 30 litra për 100 km të kaluar, përderisa Peugeot harxhimet i ka 5 litra në 100km dhe në këtë aspekt Kryetari i Komunës ka shpreh vullnet të vozitet me Peugeot, ndërsa arsyeja e posedimit me dy palë targa sigurisht është për shkak të sigurisë së Kryetarit gjatë udhëtimeve zyrtare.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0045207/21

Podujevë,

04 qershor 2021

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi